



Roli i BKUK-së në mbështetje të studimeve për Kosovën

Nga: Michael McClellan

Zyrtar për marrëdhënie publike

Me kënaqësi të madhe e përshëndesim botimin e numrit të parë të revistës së re "BIBLIOletra" të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare. Me këtë botim BKUK-ja bashkohet me bibliotekat e tjera të botës në mbështetje të "Komunitetit ndërkombëtar të studiuesve", e cila do t'i vijë në ndihmë hulumtuesve, studenteve dhe studiuesve nga e mbarë bota që të mësojnë më shumë për Kosovën dhe trashëgimin e saj të pasur historike dhe kulturore. Përvoja ime me BKUK-në nis që prej vitit 1996. Në atë kohë shumë njerëz që i njihja nuk lejoheshin që ta vizitonin apo ta shfrytëzonin bibliotekën. Një pjesë e materialeve të saja u zhdukën dhe një pjesë tjetër u asgjësua nga regjimi i Millosheviqit. Tashmë ajo kohë i takon së kaluarës, dhe jam i lumtur të them se biblioteka është e hapur për të gjitha bashkësitë e Kosovës dhe se rruga e gjatë për restaurimin e koleksioneve të bibliotekës dhe vënien e tyre në përdorim të studiuesve ka hyrë në një fazë të re nën udhëheqjen e dr. Sali Bashotës. Njëra prej detyrave më të vështira me të cilën ballafaqohet çdo drejtor dhe udhëheqësi i secilës bibliotekë është definimi i qartë i rolit dhe misionit të saj.



/ vijon në faqen 4 /



Në këtë numër

Idriz Mehmeti: Bibliotekari mund t'i ndryshojë paragjykimet në shoqëri....6

Dr. Kenneth Oberembt: BKUK po e ndryshon kursin10

Sylejman Pireva: Bibliotekat dhe infrastruktura.....8

Alan Oliver: Ex Libris.....12

Bedri Gashi: Të dhëna statistikore për bibliotekat publike në Kosovë.....14

Dokumente: Manifesti i IFLA-s për Internetin.....20

Dokumente: Ligji për Bibliotekat.....21

Projekte: Programi i automatizimit të BKUK-së.....22

Biblio letra



Dr. Sali BASHOTA

*K*rejt në fillim: para çdo nisëtiave shtrohet gjithmonë qëllimi. Në vazhden e pikëshikimit sprovohet domethënia e ideve, apo herën tjetër fakti nga fillon e procedohet kërkimi krijues, pastaj ku shenjohe funksioni e rezultati, rrjedhimisht për të prodhuar vlera konkrete në fusha të ndryshme të dijës.

Pra, çdo kohë e ka brezin e vet që synon diçka tjetër nga pararendësit. Madje, çdo brez dëshiron të ndryshojë diçka edhe në kontekstin kulturor e letrar.

Dhe esenca apo motivi inicial kapërthuret nëpër fillimin e mendimit, për të përmbushur një kërkesë, nga buron ideja për themelimin e një reviste, në të cilën do të artikulohe zërat e krijuesve dhe studiuesve shqiptarë sot.

Pra, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, tash e tutje do ta ketë revistën e vet, të pagëzuar me emrin e bukur poetik e figurativ **BIBLIO**letra.

Revista është një nismë dhe një nevojë e domosdoshme për informacionin e bibliotekarisë në Kosovë, që në fakt dëshmon një veçanti kulturore, nga mund të projektohen konceptet edhe për autenticitetin e shkrimit shqip, por edhe për kontinuitetin, zhvillimin dhe përparimin e veprimtarisë bibliotekare në përgjithësi.

BIBLIOletra do të jetë revistë që do të prezantojë modelin kulturor të bibliotekarisë në Kosovë, duke u mbështetur në përvojën dhe të arrituarat bashkëkohore të bibliotekarisë

në Evropë dhe Amerikë, madje duke synuar sistemet më të avancuara bibliotekare dhe gjithësi integrimin në informacionet më të fuqishme të komunikimit dhe të teknologjisë moderne.

BIBLIOletra do të jetë revistë e përveçme në Kosovë që do ta projektojë subjektivitetin e vet dhe të inicojë kuptimet dhe nocionet themelore të identitetit përbrenda një hapësire kulturore duke synuar dhe prezantimin e vlerave emblematisë të shkrimtarisë shqipe e më gjerë.

BIBLIOletra do të jetë revistë ku si pikë referimi do të ketë dhënien e rekomandimeve, udhëzimeve, standardeve që kanë të bëjnë me botën e librit, por edhe të kulturës, edukimit, shkencës, qytetërimit.

BIBLIOletra do të jetë revistë që do të sistemojë dijen dhe përvojën e krijuesve, duke synuar dialogun kritik në ambientin tonë letrar dhe duke e artikuluar ligjërimin për bibliotekarinë, në njërën anë dhe për letërsinë, në anën tjetër. **BIBLIO**letra do ta ketë krijimin individual dhe përkushtimin e vlerave kulturore kombëtare dhe botërore, jo duke e rindërtuar mitin për bibliotekarinë në Kosovë, por duke e funksionalizuar vetëdijësimin për vetveten.

BIBLIOletra do të jetë edhe revistë e Kujtesës së Kosovës. Këtu do të botohen shkrime të ndryshme në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera, për historinë e moçme dhe të re, për qytetërimin, trashëgiminë gojore dhe të shkruar, për identitetin kombëtar.

BIBLIOletra do të jetë edhe një sprovë krijuese publicistike, që do ta krijojë fizionominë dhe individualitetin e vet përbrenda botës kulturore shqiptare. Dhe përballë të gjitha këtyre përfytyrimeve dhe karakterizimeve provohet idealiteti. Kjo do të jetë revistë për shkrimtarinë dhe veprimtarinë bibliotekare.

Në kohën aktuale, **BIBLIO**letra synon të jetë thelbi i bibliotekarisë në Kosovë duke e funksionalizuar kërkimin për trashëgiminë e kulturës shqipe dhe duke e projektuar vizionin apo projektin e së ardhmes në procesin e zhvillimit të bibliotekarisë në shekullin 21.

Dhe krejt në fund: kjo revistë është një klithmë origjinale që kërkon konceptin e vet përbrenda universit të librit, në një kohë dhe në një vend.

Prishtinë, mars 2004

BIBLIOTEKA
KOMBËTARE
DHE UNIVERSITARE
E KOSOVËS



THE NATIONAL
AND UNIVERSITY
LIBRARY
OF KOSOVA

Botues: dr. Sali BASHOTA, Kryeredaktor: Vehbi MIFTARI

Këshilli redaktues: Shukrie RAMA, Bedri GASHI, Fazli GAJRAKU

Lektor: Muhamet ÇITAKU

Realizimi kompjuterik: Hekuran REXHEPI



Në BKUK u hap Qendra Amerikane

Më 20 nëntor të vitit 2003, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës u hap Qendra Amerikane. Themelimi i kësaj qendre erdhi si rezultat i bashkëpunimit të mirë ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe atyre të Shteteve të Bashkuara. Seksioni i Marrëdhënieve Publike të Zyrës Amerikave në Prishtinë e mbështet në mënyrë të vazhdueshme Qendrën për Këshillime të Studentëve, ndërsa në këtë vit Zyra e SHBA-ve ka dhënë një grant prej 50 mijë dollarëve për hapjen e Bibliotekës së Këndit Amerikan dhe të sallës së leximit. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e ka dhuruar hapësirën për themelimin e Qendrës Amerikane, ndërsa Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i ka dhuruar 40 mijë euro për renovimin e hapësirës së kësaj qendre. Në ceremoninë e hapjes morën pjesë personalitete të shquara vendore dhe ndërkombëtare, në mesin e tyre Presidenti i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, Shefja e Zyrës Amerikane Zonja Marcie Ries, etj. Themelimi i Qendrës Amerikane është program i përbashkët, i cili ka synim njoftimin e popullatës së Kosovës – me anë të mjeteve të edukimit në kuptimin e saj klasik – me idealet perëndimore të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut. Njëri prej qëllimeve të saja është që t’ju sigurojë kosovarëve, e posaçërisht të rinjve dhe studentëve të Universitetit të Prishtinës, informata për arsimin, kulturën, shoqërinë dhe proceset politike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Biblioteka e Këndit Amerikan, njëra prej shërbimeve të Qendrës Amerikane, ka një koleksion të larmishëm të burimeve të informacionit, duke përfshirë libra, revista, videokaseta, disqe, burime elektronike, etj. E veçanta e kësaj biblioteke është se ofron shërbime të stilit amerikan dhe bazohet më shumë në burimet e internetit se sa në

ato të shtypura. Me një fjalë, ajo është një bibliotekë elektronike, e cila i ofronë përdoruesit të saj shërbime të shpejta dhe burime nga më të ndryshmet. Baza e të dhënave të EBSCOhost, të cilat i disponon kjo bibliotekë, është një koleksion revistash elektronike të paçmueshme, të cilat përfshijnë po thuaj të gjitha lëndët që mësohen në sistemin e shkollimit të lartë në Kosovë. Duke qenë bibliotekë e tipit të hapur, përdoruesi i saj jo vetëm që mund të zgjedhë drejt për drejt në raftet e saja materialin të cilin e dëshiron, por edhe mund ta huazojë atë në shtëpi. Qendra Amerikane, si një ombrellë nën të cilën funksionojnë Biblioteka e Këndit Amerikan, Shërbimet Këshilluese për Studentë dhe ato të Testimit, organizon, po ashtu, aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me botën e librit e të kulturës në përgjithësi, të tilla si takime, seminare, biseda të lira, këshillime për kosovarët që dëshirojnë të studiojnë në SHBA, mbrëmje poetike, ligjërata, ekspozita, shfaqje të filmave, kurse për mësimin e gjuhës angleze, ndoshta edhe programe për fëmijë, etj. Siç tha edhe vet Zonja Ries në fjalën e saj të hapjes se “Qendra Amerikane do të jetë forum për shkëmbimin e ideve gjerë folësit nga Shtetet e Bashkuara, Kosova dhe nga vendet e tjera mund ta shfrytëzojnë këtë hapësirë për të ndarë njohuritë dhe përvojën e tyre me popullin e Kosovës”. Qendra Amerikane me llojin e shërbimeve të cilat i ofronë është unike për Kosovën. Ajo do të jetë një urë e vërtetë ndërmjet popullit të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara, një vend i cili do t’i lartësojë dhe demonstrtojë në fjalë dhe vepra vlerat e demokracisë, tolerancës dhe diversitetit, të cilat janë unike për Amerikën.

Besim KOKOLLARI
Biblioteka e Këndit Amerikan

Roli i BKUK-së në mbështetje të studimeve për Kosovën

/ vijon nga faqja 1 /

Këtu në Kosovë - një shoqëri e dalë nga lufta e cila po përpriqet që t'i përmbush standardet e pranuar për shoqërinë e saj, dhe e cila po punon në integrimin e të gjitha bashkësive etnike të Kosovës duke i siguruar informacionet me të reja nga e mbarë bota, që do t'u ndihmonte studiuesve në punën e tyre - kjo paraqet një punë jo vetëm fisnike por edhe nga më të rëndësishmet për të ardhmen e Kosovës. Në shekullin e 21, nevoja për informacione dhe të dhëna të tjera është me e rëndësishme se kurrë më parë dhe se bibliotekat e Kosovës duhet të punojnë shumë nëse dëshirojnë t'i shërbejnë klientelës së tyre ashtu siç duhet.

Vendi im është duke punuar në mënyrë aktive për ta ndihmuar këtë proces. Dr. Ken Oberembt punoi për 10 muaj në BKUK, në vitin 2002 dhe 2003, dhe Plani i tij strategjik për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare do të jetë në duart e publikut gjatë "Javës së Bibliotekës në Kosovë" në prill të këtij viti. Si Biblioteka ashtu edhe Ministria e Arsimit e kanë mbështetur vizionin e Dr. Oberembt-it për BKUK-në, si një plan për zhvillimin strategjik të këtij institucioni vital, ku disa prej rekomandimeve të tij tashmë janë reflektuar në ligjin për biblioteka dhe janë në implementim e sipër nga personeli i BKUK-së. Po ashtu, jemi duke punuar për së afërmi me Ministrinë dhe BKUK-në për ta zhvilluar një personel profesional bazë për Bibliotekën e re Qendrore të Universitetit të Prishtinës, duke shpresuar në zgjerimin e këtij trajnimi edhe tek personeli i BKUK-së. Kjo ngritje profesionale e personelit, së bashku me zhvillimin e burimeve elektronike të bibliotekës përmes Internetit, teknologjisë së CD-ROM-ve dhe mënyrës tradicionale të pasurimit me libra e dokumente të tjera, do t'u mundësojnë studentëve, fakulteteve dhe studiuesve të kenë mundësi të shfrytëzimit, në mënyrë virtuale, të burimeve intelektuale të çdo grupi gjuhësor të botës dhe të marrin



pjesë në mënyrë aktive në univerisin e gjerë intelektual evropian dhe amerikano-verior.

BKUK-ja, si institucion, do të luajë rol të rëndësishëm në zhvillimin e ardhshëm të Kosovës si një shoqëri tolerante, shumë etnike, e cila do t'i respekton kulturat dhe kontributet e të gjitha bashkësive të saja përbërëse. Siç kam thënë edhe në fjalimin tim me rastin e hapjes së "Javës së Bibliotekës në Kosovë" në vitin e kaluar, BKUK-ja duhet të jetë vendi kryesor për ruajtjen dhe deponimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës. Për këtë arsye e kemi mbështetur vazhdimisht procesin e katalogimit të dorëshkrimeve islamike dhe orientale të Kosovës në mbarë territorin e saj, me qëllim të mbrojtjes së këtij thesari të çmueshëm të librave, dorëshkrimeve dhe dokumenteve të periudhës osmane në Kosovë, të shkruara në shqip, turqisht, persisht, arabisht si dhe në gjuhë të tjera. Kështu që përpjekje të ngjashme duhet të bëhen për ta dokumentuar edhe trashëgiminë krishtere dhe hebreje të Kosovës, duke e bërë katalogimin e materialeve të shkruara në latinisht, shqip, serbo-kroatisht, madje, edhe në hebraisht. Megjithatë, vetëm kjo nuk do të mjaftojë. Në këto pesë vjetët e pasluftës, që prej vitit 1999, kemi parë zhvillime të shpejta në sferën politike, zhvillime të cilat do të bëhen edhe më intensive me shkuarjen e Kosovës drejt

vlërësimit të progresit të Standardeve, dhe po që se gjithçka shkon mirë do të hyhet në procesin e përcaktimit të statusit të saj përfundimtar. Gjeneratat e ardhshme të studiuesve, madje edhe të atyre të cilët do të merren me studime pas dy viteve, do të dëshironin të dinin se si u zhvilluan partitë e ndryshme politike të Kosovës, se si i formuluan programet e tyre për secilën fushatë zgjedhore, se si është zhvilluar procesi i fushatave zgjedhore, cilët ishin kandidatët konkurrues, si dhe të kenë qasje në letrat dhe dokumentet të cilat do ta tregonin se si ato komunikonin me popullatën vendëse dhe me personalitetet e ndryshme ndërkombëtare. Ata do të dëshironin të lexonin secilin numër të Kohës Ditor, Botës Sot, Zërit dhe Glas Jugas, si dhe shumë e shumë botime në gjuhë të ndryshme të dala këtu. Të gjitha këto dokumente – të cilat janë me dhjetra mijra të tilla – duhet të mblidhen, katalogohen dhe të vëhen në shfrytëzim të studiuesve po që se BKUK-ja synon ta përmbush misionin e saj. Mos harroni – askush nuk brengoset më shumë se ju për historinë tuaj. Nëse JU nuk e ruani historinë tuaj, nëse JU nuk i mblidhni dokumentet dhe materialet të cilat i përbëjnë të dhënat tuaja historike, nëse JU nuk i katalogoni dhe ruani ato për brezat e ardhshëm, atëherë mos prisni që dikush tjetër do ta bëjë këtë gjë për ju.

Si pjesë përbërëse e bashkësisë së madhe botërore, Kosova e ka për obligim që ta ruajë dhe t'ia prezantojë botës historinë dhe kulturën e saj, mirëpo është e obliguar që ta bëjë këtë në mënyrë të paanshme, objektive dhe gjithpërfshirëse duke e paraqitur realitetin e të gjitha diversitetëve kulturore të Kosovës. Po që se vepron kështu, atëherë, BKUK-ja është në rrugën e drejtë që të jetë lidere dhe shembull për tërë Kosovën se si duhet të vlerësohet dhe të paraqitet trashëgimia dhe kultura shumë etnike e Kosovës, si brenda vendit ashtu edhe në botë. Ka qenë kënaqësi për mua të punojë me personelin dhe udhëheqësinë e BKUK-së gjatë qëndrimit tim në Kosovë. Po e them edhe një herë, BKUK-ja është një institucion me të cilin do të mund të krenohen kosovarët, por asaj i nevojitet mbështetja e jonë që ajo të ketë sukses në përmbushjen e misionit të saj. Për një gjë jam i bindur se BKUK-ja mund t'i arrijë objektivat të cilat ia kanë vënë institucionet e Kosovës duke e mbështetur dhe pranuar planin strategjik të dr. Oberembit-it. Kur kjo të ndodhë, paraqitja e Kosovës në qarqet intelektuale do të avancohet pasi që shumë studiues do të kuptojnë dhe njohin unikalitetin e burimeve kërkimore të cilat mund të gjenen vetëm këtu dhe se BKUK-ja do të njihet ndërkombëtarisht si qendër e veçantë kërkimore.

Seminari “Fëmijët dhe të rinjtë në bibliotekat publike”

Në kuadër të nxitjes dhe të përvetësimit teorik dhe praktik të nevojave pozitive, në BKUK, nga dt.14-15 tetor 2003, u mbajt seminari me titull “Puna me fëmijët dhe të rinjtë në bibliotekat publike”, në Amfiteatrin e Madh të BKUK-së. Ligjëruese ishte lektorja dhe specialistja e Departamentit për Fëmijë në Bibliotekën Publike të Zarës, Dajana Brunac. Për dy ditë me radhë, para 46 seminaristëve nga bibliotekat publike të Kosovës, specialistja nga Zara ligjëroi e demonstroi praktikisht tërë kompleksitetin e bibliotekës për fëmijë dhe të rinj, dhe metodologjinë e punës me moshat deri në 14 vjeç. Temat shtjelluese të seminarit ishin të përqendruara në prezantimin e informatave të përgjithshme për sektorët e fëmijëve dhe të rinjve, në aktivitetet e fëmijëve parashkollorë, shkollorë, të shoqëruar me prindër ose me kujdestarë. Ishte shumë funksional prezantimi praktik i lojërave, i librave me ilustrime, i lodrave, i shfaqjeve me kukulla, improvizimi i këndit të prindërve, për moshat 0-3 vjeç,

3-7 vjeç dhe 7-14 vjeç. Tërheqja profesionale e aktivitetëve për fëmijë dhe të rinj nëpër bibliotekat publike, si për shembull: lojërat, videot, CD-të, kompjuterët, zbulimi i talentëve, diskutimet rreth librit të lexuar, garat, kuizet, ekspozitat, improvizimi i punës së bibliotekarëve të rinj dhe punëtoritë e ndryshme, që vihen në funksion të zhvillimit të prirjeve, shkathtësive, sjelljes, kulturës së përgjithshme, ambientimit të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe nxitja e shumë e shumë vetive të tjera edukativo-arsimore, nxorën në pah se bibliotekat tona për fëmijë dhe të rinj, sidomos sektorët nëpër bibliotekat publike, duhet që të ngriten doemos dhe të reflektojnë në edukimin dhe në arsimimin, që nga moshat fare të njoma e deri tek të rinjtë e moshës 14 vjeçare.

Si mesazh i këtij seminari doli se bibliotekarët që punojnë me fëmijë sjellin dobi me kultivimin serioz të individit në shoqëri dhe transmetojnë një mision të rëndësishëm për të ardhmen e shoqërisë.

IDRIZ MEHMETI

Bibliotekari mund t'i ndryshojë paragjykimet në shoqëri

Bibliotekari është ai që duhet të ndikojë në ndryshimin e paragjykimeve për profesionin e tij, në rrethin ku punon. Për fat të keq, ky profesion te ne respektohet shumë pak. Punonjësi bibliotekar duhet të jetë mjaft i përgatitur në profesionin e tij, për të ndikuar në rrethin ku punon, në ndryshimin e paragjykimeve për këtë lëmi të kulturës sonë. Lirisht mund të them se te ne nuk njihet ky profesion, prandaj respektohet kaq pak

Idriz Mehmeti, punëtor shumëvjeçar në ish-Shërbimin Amë, tash Departamenti për Hulumtimin dhe për Zhvillimin e Veprimtarisë Bibliotekare në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, flet për përvojën e tij si referent analitik dhe për zhvillimin e bibliotekave publike në Kosovë.


Cili është pozicioni juaj në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës?

Në BKUK punoj si referent analitik në Departamentin për Hulumtimin dhe për Zhvillimin e Veprimtarisë Bibliotekare. Unë, në këtë departament, përcjellë punën e bibliotekave publike dhe speciale (këtë punë e përcjellë prej vitit 1962). Bashkë me kolegët e tjerë vizitojmë bibliotekat në terren, përcjellim punën profesionale. Mandej, vizitojmë lokalitete e bibliotekave, për të parë se a i përgjigjen standardeve të parapara me ligj për këtë veprimtari. Në bazë të formularëve që i dërgoj në terren mbedh shënime për të gjitha veprimtaritë që i kryejnë këto biblioteka. Dhe, në bazë të të dhënave statistikore, që i marr, formoj vjetarin statistikor të bibliotekave publike në Kosovë. Në bashkëpunim me kolegë marrë pjesë në ndihmën profesionale, që ky departament iu ofron të gjitha bibliotekave.

Ju keni kryer dhe kryeni punën e referentit analitik. Në çfarë gjendje është bibliotekaria e Kosovës sot, në veçanti bibliotekat publike?

Sot, pos Bibliotekës Ndërkomunale të Prishtinës, nuk mund të lavdërohem se kemi një kuadër të nivelit profesional. Në vitet e fundit, për aftësimin e kuadrit bibliotekar, organizuam disa seminare me ligjërues nga Shqipëria, Kroacia dhe Sllovenia, por për ta aftësuar këtë kuadër që e kemi dhe atë që duhet pranuar, pos vullnetit, duhen edhe mjete materiale, e ato, fatkeqësisht nuk i kemi. Po bëhen përpjekje, që

të paktën në bibliotekat komunale, të pranohet kuadër me kualifikim të lartë dhe i ri, që në këtë drejtim ta ndërrojmë këtë gjendje që e kemi. Për të pasur sukses në këtë punë, rol më rëndësi luan edhe Qeveria me ministritë e saj, që ta përkrahë këtë lëmi të kulturës sonë, dhe ky kuadër të ketë tretman



>> **Idriz Mehmeti**

të barabartë me të tjerët, në të kundërtën, kjo gjendje që është tani do të vazhdojë edhe shumë kohë.

Lufta shkatërroi disa biblioteka. Para vitit 1990 ishin 25 biblioteka komunale me një fond prej 947.602 librash, një rrjet prej 158 bibliotekave me 1.236.627 libra. Bibliotekat publike kishin 332 lokale 9.805 m², 18 salla leximi për të rritur, 10 salla leximi për fëmijë, etj.

Pas vitit 1999 mbetën 22 biblioteka komunale me 618.913 libra, me një rrjet prej 96 bibliotekave, me 597.083 libra. Pastaj, 170 lokale me 6.665 m², 12 salla leximi për të rritur dhe 8 salla leximi për fëmijë. Kur bëjmë krahasimin e kësaj statistike del se lufta i shkatërroi 3 biblioteka komunale dhe 92 degë. U zhdukën dhe u dogjën 968.233 libra, 3 salla leximi për të rritur dhe 2 salla leximi për fëmijë. Bibliotekat publike humbën 170 lokale me 6.665 m². Kjo është humbje mjaft e madhe. Këtu nuk po i përmendi bibliotekat e shkollave, të cilat kanë pasur humbje edhe më të mëdha, kur dihet se gati të gjitha shkollat nëpër fshatra janë djegur e shkatërruar, e gati të gjitha prej tyre kanë pasur biblioteka, me një fond solid. Mandej, bibliotekat e enteve e të institucioneve të tjera.

Para luftës kemi pasur biblioteka, gati në të gjitha fabrikat, me një fond librar shumë, shumë të pasur. Këtu, po i përmendi vetëm disa, ku kam marrë pjesë në rregullimin e fondit të tyre: Biblioteka e Trepçës në Zveçan; "Emin Duraku" në Gjakovë; "Ballkani" në Suharekë; Fabrika e Lëkurëpucëve në Pejë; Fabrika e Duhanit në Gjiilan; "Printex" në Prizren; "Dratex" në Dragash; Fabrika e Pllakave të Qeramikës "Karaçevë" në Kamenicë, e shumë të tjera, që tash nuk ekzistojnë. Nuk mund të mos i përmend edhe bibliotekat, që i kanë pasur objektet fetare. Këtu, do ta veçoj Teçen e Bektashinje në Gjakovë, të cilën, sa ishte gjallë, e ka udhëhequr Baba Qazimi, që ishte ndër ata intelektualë, që u angazhuan për hapjen e shkollave të para shqipe. Ajo teçe kishte një bibliotekë me një fond të pasur të librave të vjetër dhe të rrallë, bile kishte edhe mbi 100 dorëshkrime. Në vitet '70-të kam punuar në regjistrimin e kësaj biblioteke. Pas regjistrimit, baba Qazimi pati shprehur dëshirën që pjesën më të madhe të këtyre librave, që kishin një vlerë të madhe për arsimin dhe kulturën tonë, t'ia falë Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës. Fatkeqësisht, ai regjistrim nuk u krye. Baba Qazimi ndërroi jetë, e ato libra nuk erdhën kurrë në bibliotekën tonë. Gjatë luftës, Teçeja e Bektashinje u dogj dhe u shkatërrua deri në themel dhe ai thesar u zhduk përgjithmonë. Këto janë ato humbje të mëdha, që i pësoi bibliotekaria kosovare.

Ndoshta nuk mund të jap përgjigje të plotë se në ç'gjendje janë sot bibliotekat publike në Kosovë, nuk mund të jap ndonjë përgjigje të plotë, meqenëse nuk kam pasur rast t'i vizitoj të gjitha bibliotekat, kuptohet pas luftës. Gjatë vizitave që i kemi bërë, rezulton se gjendja është mjaft e vështirë. Madje, ajo m'i kujton vitet '60-të. Kuadri, në të shumtën është me kualifikim të mesëm, pos bibliotekave ndërkomunale, që kanë pranuar kuadër të ri, me kualifikim të lartë. Lokali i bibliotekave komunale në pjesën më të madhe është i pamjaftueshëm dhe aspak i përshtatshëm, që biblioteka të zhvillojë veprimtarinë e saj. Edhe ato pak libra që blihen nuk kanë as ku t'i vendosin. Fondi librar është i parregulluar sipas normave bibliotekare. Pos Bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë, të gjitha bibliotekat e tjera, ndërkomunale dhe komunale, nuk kanë skedar të kompletuar. Atë çka kam vërejtur, e që më habit për të mirë, është numri mjaft i madh i lexuesve, edhe pse në të shumtën e rasteve nuk e gjejnë librin që e kërkojnë. Për ta ndryshuar këtë gjendje, pos mjeteve materiale duhet punë dhe vullnet i madh. Duhet angazhim i madh i atyre që punojnë nëpër këto biblioteka dhe i atyre nga të cilët varet zhvillimi i kësaj veprimtarie. Nga përvoja e di se ata që vendosin, gjithmonë bibliotekën e lënë të fundit. Vetëm një shembull që e vërteton këtë: gjatë këtyre viteve, të pasluftës, shumë donatorë ndërkombëtarë ndërtuan shkolla e ambulanca e shumë objekte të tjera të infrastrukturës, por asnjë

bibliotekë, pos disa merremtimeve që i bënë në bibliotekat ndërkomunale në Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë e Prizren. Për këtë, fajin e mbajmë ne kosovarët, që nuk jemi paraqitur me projekte dhe me kërkesa këmbëngulëse. Kosova nuk mund të krenohet se kësaj veprimtarie i ka kushtuar kujdes të mjaftueshëm. Prej pas Luftës së Dytë Botërore nuk është ndërtuar, prej themeli, asnjë objekt enkas për bibliotekë, pos Bibliotekës Popullore dhe Universitare (siç quhej atëherë) që meritën për këtë e mban drejtori i atëhershëm i kësaj biblioteke, z. Ismet Spahiu, i cili më këmbëngulje iu imponua Kuvendit Krahinor, të atëhershëm, që në planin shoqëror ta fusë ndërtimin e kësaj biblioteke dhe t'i ndajë mjetet e nevojshme për këtë investim. Ky është një shembull, që lë për t'u kuptuar, se vetë bibliotekarët duhet të jenë këmbëngulës në kërkesat e tyre.

Sipas jush, a duhet që bibliotekari t'i ndërrojë paragykimet për profesionin e tij, apo të rrethit shoqëror, kur dihet se në botë bibliotekat radhiten në mesin e institucioneve më të fuqishme?

Në radhë të parë, ata që përcaktohen të merren me këtë profesion, siç e thatë ju "që radhiten në mesin e institucioneve më të fuqishme", në radhë të parë duhet ta duan atë dhe të punojnë shumë në ngritjen profesionale, meqenëse është profesion deficitar, ku mungon shkollimi përkatës. E, ngritja profesionale arrihet me leximin e asaj që shkruhet për bibliotekari dhe me punë praktike. Në të kundërtën, gjatë punës së tyre do të hasin në shumë sfida. Ata që e njohin gjuhën angleze e kanë më të lehtë për t'i përcjellë të arriturat botërore në këtë veprimtari, sepse atë ua mundëson teknika moderne-interneti.

Kush duhet t'i ndërrojë paragykimet? Bibliotekari është ai që duhet të ndikojë në ndryshimin e paragykimeve për profesionin e tij, në rrethin ku punon. Për fat të keq, ky profesion te ne respektohet shumë pak. Për këtë kam folur mjaft, më lart. Prandaj, punonjësi bibliotekar duhet të jetë mjaft i përgatitur në profesionin e tij, për të ndikuar në rrethin ku punon, në ndryshimin e paragykimeve për këtë lëmi të kulturës sonë. Lirisht mund të them, se nuk njihet e pak respektohet ky profesion, e sidomos mendoj për ata që janë në ato vende, ku vendoset fati i kësaj veprimtarie. Bibliotekari, pos ngritjes intelektuale e profesionale, që duhet të ketë, duhet të jetë këmbëngulës në punën dhe në kërkesat e tij, në të mirë të këtij profesioni. Në vendet e tjera, bibliotekari nuk është ai që duhet t'i imponohet rrethit, sepse rrethi e njeh rëndësinë e librit dhe është i vetëdijshëm se për ngritjen dhe për zhvillimin e tij, libri është bazë për të gjitha, e mu për këtë, edhe investohet aq shumë në ngritjen dhe në zhvillimin e bibliotekarisë në botë.

Bisedoi: Hazbije QERIQI

Bibliotekat dhe infrastruktura

Në gjendjen çfarë janë sot bibliotekat publike në të gjitha qytetet tona, është krejt e pamundur që ato të funksionojnë në mënyrë normale. Me kaq hapësirë dhe sipërfaqe sa zënë ato, zhvillimi i veprimtarisë bibliotekare dhe i aktiviteteve të ndryshme kulturore, është më shumë se i përgjysmuar. Nuk ka mundësi të formohen as sektorët e domosdoshëm, e lë më aq sa i nevojiten bibliotekës për kryerjen e punëve; mungojnë sallat e përshtatshme, kurse në ndonjë sish mungojnë edhe sallat për përdoruesit e grupmoshave të ndryshme.

Sylejman PIREVA

*J*anë disa standarde që lypset plotësuar para se të hapet një bibliotekë, por ndër të parat është përm-bushja e standardit të infrastrukturës. Dhe para se të ndodhë kjo, e para punë që duhet nisur drejt konkretizimit të idesë, është projekti i godinës së bibliotekës nga ekspertët që e njohin mirë jo vetëm arkitekturën, por në këtë rast edhe lëmin e bibliotekarisë. Kur këto dy dije të jenë zotëruar mirë dhe në shkallë të lartë, atëherë mund të dalë një projekt i mirë që e bën bibliotekën për të qenë funksionale. Parimisht kështu e kërkojnë standardet bibliotekare dhe sigurisht kështu veprohet në vendet e zhvilluara. E, ku ndodhet vendi ynë në këtë pikë? Mbase në fillim, ose as në fillim!

NË KOSOVË: VETËM DY BIBLIOTEKA ME GURTHEMELIN SIPAS PROJEKTI

Nga të gjitha bibliotekat sa veprojnë në tërë territorin e Kosovës vetëm dy biblioteka e kanë përjetuar vënien e gurthemelit dhe më pastaj prerjen e shiritit, të ndërtuara sipas projektit të arkitektëve dhe të bëra publike për media se “filloi ndërtimi i një biblioteke të re” ose “para shumë pjesëmarrësve dhe të ftuarve të tjerë u bë përirimi i akëcilës bibliotekë...”. Vetëm këto të dyja! Dhe që të dyja këto biblioteka ndodhen vetëm në Prishtinë, njëren prej të cilave tashmë e njohin jo vetëm shumica e shqiptarëve të rritur e të mitur, por edhe miliona njerëz të botës, e kjo është Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, kurse e dyta, është “Biblioteka përkujtimore e fëmijëve” (e ndërtuar në vitin 1985), që gjendet në oborin e shtëpisë së shkrimtarit tonë të ndjerë, Hivzi Sulejmanit, e realizuar sipas amanetit të vetë Hivziut, por që nuk e ka përjetuar këtë vepër për së gjalli. S’ka dyshim se këtë e njohin shumë më pak në krahasim me të parën

dhe atë më tepër fëmijët se të rriturit.

Dhe vetëm kaq?! Po, vetëm kaq. Këto janë tepër pak për kryeqytitin e shtetit të Kosovës. Gjithë territorin e Prishtinës, që edhe të huajtë e njohin për “goxha qytet”, përveç Bibliotekës Kombëtare, e “mbulojnë” vetëm edhe një bibliotekë publike, siç është Biblioteka Ndërkomunale “Hivzi Sulejmani” dhe katër degët e saj, dy nga të cilat punojnë nën çdo standard të lejueshëm, si bibliotekat “Përrallat” dhe “Lektura” në lagjen “Ulpiana”, kurse hiç më mirë nuk qëndron as vetë kjo biblioteka kryesuese e tyre. Diçka më “mirë” qëndron puna me bibliotekën në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve, por edhe kësaj, nga lakmia e atyre të Pallatit për përfitim të një qiraje më të mirë, gjysmën e lokalit e shfrytëzon kompania e IPKO-s!

NË SHUMË KOMUNA, BIBLIOTEKAT EKZISTOJNË VETËM FORMALISHT

Po ku ndodhen, atëherë, qytetet e tjera në këtë plan, e që nuk janë më pak të rëndësishme? Disa qendra më të mëdha, siç janë Gjakova, Mitrovica, Prizreni, Ferizaji e ndonjë tjetër, kanë bërë përpjekje, që në mungesë të objekteve të destinuara për bibliotekë, të përshtasin dhe të improvizojnë ndonjë ndërtesë sa për të thënë, ose të bëhen hisedarë nën një kulm me lëmenjtë e tjerë të kulturës, si me filmin, teatrin, rekreacionin, amatorizmin, sportin, etj., të cilët në një rivalitet për të dominuar, më shumë e kanë penguar zhvillimin e njëri-tjetrit se sa që e kanë ndihmuar, dhe thuaja gjithherë më së keqi kanë përfunduar bibliotekat! Kjo gjendje është kështu posaçërisht në shumicën e komunave më të vogla dhe jo vetëm në ato, si p.sh. Lypiani, Kastrioti, Drenasi, Klina etj., por edhe Besiana, Vushtrria etj. Prandaj nuk është për t’u çuditur, përse në asnjërin nga këto qytete, e të mos flasim për ato më të vogla, nuk ndodhi nga asnjë pushtet më i hershëm e as më i vonshëm, më i vjetër e as më i ri, dhe



as nga ky i sotmi, ta begenisë që ta vëjë gurthemelin e ndërtimit të një biblioteke kudo qoftë! Por, siç u tha më lart, në këtë pikë s'ka si të mburret as Prishtina, pasi vetë Biblioteka Ndërkomunale, që është e dyta për kah rëndësia pas Bibliotekës Kombëtare, dhe e vetmja e këtij tipi në këtë qytet, vazhdon të punojë në ndërtesë të papërshtatshme, që mund të shërbejë për shumëçka tjetër, por më së paku për bibliotekë.

DISA SHKOLLA TË REJA, POR ASNJË BIBLIOTEKË

Është mirë që ekzistojnë statistikat, përndryshe s'do të mund të besonim se ka mundur të ndodhë diçka e këtilë. Gjatë luftës së fundit janë evidencuar 100 biblioteka publike, shkollore dhe familjare të djegurja e të shkatërruara nga okupatori dhe gati po kaq edhe shkolla.

Fatbardhësisht, shumica e këtyre shkollave janë ndërtuar, madje edhe më të mira se ç'kanë qenë të parat, por në asnjë qytet të Kosovës nuk ndodhi që të shohim asnjë përrurim të ndonjë biblioteke, madje as vënien e gurit themeltar. Ndërsa sa herë zihet në gojë emri bibliotekë, thuhet me dinjitet se ajo shërben për përhapjen e njohurive, kulturës, arsimit, shkencës, etj. etj., por kjo bëhet vetëm deklarativisht, sepse për ta luajtur këtë rol, ajo duhet të ketë një infrastrukturë fort funksionale, ashtu siç e parashohin standardet moderne bibliotekare dhe arkitekturale. Kurse, kjo iu mungon të gjitha bibliotekave tona publike.

FUNKSIONIMI I BIBLIOTEKËS, I KUSHTËZUAR NGA INFRASTRUKTURA

Në gjendjen çfarë janë sot bibliotekat publike në të

gjitha qytetet tona, është krejt e pamundur që ato të funksionojnë në mënyrë normale. Me kaq hapësirë dhe sipërfaqe sa zënë ato, zhvillimi i veprimtarisë bibliotekare dhe i aktiviteteve të ndryshme kulturore, është më shumë se i përgjysmuar. Nuk ka mundësi të formohen as sektorët e domoshëm, e lë më aq sa i nevojiten bibliotekës për kryerjen e punëve; mungojnë sallat e përshtatshme ose diku fare për përdoruesit e grupmoshave të ndryshme të bibliotekës; për punën e internetit dhe të shfrytëzimit të teknologjisë së re; por mungon në rend të parë lokali i përshtatshëm për vendosjen e koleksioneve, siç parashohin standardet e preferuara, që përdoruesit të kenë lehtësira për qasje të pavarur në kërkim të tyre, madje duke mos

përfshijtur këtu edhe përdoruesit e hendikepuar, që pa pengesa, me mjetet e tyre lëvizëse, t'u qasen lirisht koleksioneve për të arritur atë që dëshirojnë. Dhe përderisa gjendja e këtyre bibliotekave është kështu si është, ato kurrë nuk do të mund të funksionojnë si duhet. Edhe më keq e kanë ato biblioteka që punojnë brenda institucionit epror prej të cilit varen (qendrat- shtëpitë e kulturës). Puna e parë që duhet bërë do të ishte përpjekja për pavarësimin e tyre.

Nga kjo rezulton, se pa zgjidhjen e problemit të infrastrukturës, as që do të kemi bibliotekë për të qenë.

ZGJIDHJA: NË ÇDO QYTET NGA NJË BIBLIOTEKË TË RE

Transicioni që po kalon shteti i Kosovës dhe populli i saj, nuk po përballohet lehtë. Kjo po hetohet në të gjitha sferat e jetës, prandaj edhe në përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës. Çfarë të ndërtohet më parë, do të shtrojë pyetjen dikush, pas gjithë atyre shkatërrimeve nga okupatori në një anë dhe të asaj që është trashiguar në anën tjetër. Por në këtë çast duhet të vlejë parimi i prioritetit. Dhe në agjendën e prioriteteve të zëvend edhe ndërtimi i bibliotekave. Jemi të informuar se në komunat e Prizrenit dhe të Gjakovës diçka e mirë ka lëvizur, se janë caktuar trojet për këtë qëllim.

Shpresojmë që organet qeveritare të kenë siguruar projektet dhe mjetet për këtë dhe së shpejti të shohim fillimin e punimeve me hudhjen e gurthemelit, dhe pa vonuar shumë edhe prerjen e shiritit, të bibliotekave të para pas çlirimit. Mbase këtë shembull do ta ndjekin edhe qytetet e tjera.

DR. KENNETH OBEREMBT

BKUK po e ndryshon kursin

Keni qëndruar 10 muaj në Kosovë, cilat i konsideroni si përparësi dhe të meta të BKUK-së?

Përgjegjja ime ndaj pyetjes suaj do të jetë më tepër strategjike se sa taktike. Me fjalë të tjera, përgjigjja ime do të ketë në fokus të metat nën të cilat fshihen të metat e tjera dhe përparësitë nën të cilat fshihen përparësitë e tjera. Sa i përket të metave, më lejoni t'i përmendi vetëm tri syresh: Njohuritë bibliotekare të dala jashtë përdorimit. Pa njohuri të reja, thjeshtë nuk mund të ekzistojë një bibliotekë e ngritur në standardet bashkëkohore. BKUK-ja mbeti prapa si rezultat i rrethanave dhe shkaqeve që nuk ishin as nën kontrollin e saj e as të personelit të tanishëm të saj. Megjithatë kjo është e vërtetë. Sistemi i aftësimin të bibliotekarëve të shtetit të Jugosllavisë u ndërpre kah fundi i vitetve të 1980-ta. Si rrjedhojë, personeli i cili u dëbua nga biblioteka nuk pati mundësi t'i shfrytëzojë programet formale të trajnimit. Tash BKUK-ja vepron në rrethana krejtësisht të ndryshme, kështu që inkorporimi i njohurive të reja në veprimtarinë e bibliotekës do të jetë i mundimshëm dhe i ngadaltë; Shkathtësitë teknologjike nën standardet e duhura. Pamundësia për t'i ngritur shkathtësitë teknologjike të personelit për shkak të mungesës së kompjuterëve është vetëm njëra pjesë e historisë së vonshme të BKUK-së. Personeli i BKUK-së ka pasur kontaktin e parë me kompjuter në një moshë madhore e kjo ka domethënie të madhe. Sot bibliotekat e SHBA-ve janë në duart e njerëzve të cilët janë rritur që prej fëmijërisë së tyre me kompjuter dhe me elementet e tyre përcjellëse. Fatëkeqësisht, njerëzit të cilët kanë pasur mundësinë ta përdorin kompjuterin për herë të parë në moshë të shkuar, nuk mund ta kuptojnë atë e as të përparojnë aq shumë sa i përket fitimit të shkathtësive në teknologjinë e informimit të bibliotekarisë moderne, e cila mbështetet në kompjuter, në karahasim me kolegët e tyre më të rinjtë; Njohuritë e pamjaftueshme të gjuhës angleze. Pjesa më e madhe e literaturës profesionale në lëmin e bibliotekarisë, pa dyshim që është në gjuhën angleze (e në një shkallë shumë më të vogël gjendet edhe në gjermanisht e frëngjisht). Ndërsa, pjesa më e madhe e personelit të BKUK-së, ka njohuri të gjuhës angleze vetëm sa për ta lexuar e kuptuar titullin e një faqeje, e cila është e pamjaftueshme nëse dëshirojnë të qëndrojnë në hap me zhvillimet ndërkombëtare në lëmin e bibliotekarisë, për të cilën mund të gjenden informata si në formën e shtypur po ashtu edhe në internet, e të mos flasim për përdorimin e mjeteve të informimit dhe të përpunimit të cilat i ofron faqja e internetit, apo zhvillimin e komunikimit me agjen-



>> Dr. Kenneth Oberembt

sitë tregtare të cilat merren me shitjen e materialeve bibliotekare. Krahas punësimit të personelit me njohuri të gjuhës angleze, BKUK-ja duhet të zhvillojë një program për të përmbledhur e përkthyer pjesë të rëndësishme të materialeve të literaturës profesionale nga anglishtja, e cila do t'i hynte në punë të gjithë personelit të bibliotekës. T'i kthehem tash përparësive të BKUK-së, më lejoni që prapë t'i përmendi vetëm tri syresh: Kompetencat e përcaktuara me ligj. Ligji i ri për Biblioteka në Kosovë e ka përcaktuar qartë agjendën e BKUK-së për veprimtarinë e saj në të tashmen dhe në të ardhmen. Ligji i ri e heq çfarëdo dyshimi për rolin e BKUK-së dhe poashtu e heq çfarëdo justifikimi nëse nuk përmbushet ai rol, Vendosmëria për të ecur përpara. Duke iu falënderuar administratës së tanishme të BKUK-së, e cila ka vetëm një dëshirë të vetme, që ta ndryshojë komplet kursin e bibliotekës dhe ta vejë atë në drejtimin e duhur që do ta shpiente drejt standardeve ndërkombëtare. Më në fund, kjo është duke u bërë realitet pas kaq viteve të ngecjes; Mbështetja e komunitetit. Populli i Kosovës, madje edhe në kohët më të vështira, e ka mbajtur lart BKUK-në. Për ta ajo është një simbol kulture dhe ata i gëzohen pa masë sukseseve të saja. Në të ata, po ashtu, mbajnë shpresa të mëdha. Por mos të harrojmë edhe mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar (p.sh., të Zyrës Amerikane në Prishtinë). Kujdesin dhe shqetësimin që e kanë treguar te dy komunitetet paraqet për BKUK-në një bazë të mirë në të cilën ajo mund të mbështetet.

Kur e kujtoni kohën të cilën e keni kaluar në BKUK, a gjeni diçka të cilën do të kishit pasur dëshirë të bënit ndryshe?

Planin themelor me të cilin kam ardhur në BKUK nuk do ta

ndryshoja, edhe pse më mori një muaj më tepër se sa e pararendojo ta punësoja drejtorin e përhershëm dhe disa muaj më tepër se sa e prisja për ta përfunduar Planin Strategjik të Bibliotekave. Megjithatë, qëndrimi im në Kosovë ishte zgjatur për të më dhënë kohë që t'i përfundoja këto detyra. Për fatin tim të mirë, ekipi menaxhues i BKUK-së nën udhëheqjen e Dr. Bashotës i mori menjëherë përgjegjësitë, duke më lejuar që të përqëndrohesha në përpjekjet e mia të përgatitjes së planit strategjik, bërjes së analizave të rrethanave, intervistave dhe gjërave të tjera të cilat më hynin në punë për këtë qëllim.

Po që se do të duhej ta bëja tërë atë punë që nga fillimi, definitivisht se do të doja ta kisha përkthyesin tim, i cili do të më ndihmonte, që nga dita e parë. Ndërsa gjatë qëndrimit tim në Kosovë, i kam kaluar tre muajt e parë pa përkthyes (një të tretën e gjithë qëndrimit tim). Megjithatë kjo kishte edhe anën e saj të dobishme. Ajo më detyroi t'i kushtoja më tepër vëmendje gjesteve, e cila në një farë mase tregon se çfarë mendojnë dhe ndjejnë njerëzit, sesa do t'i kushtoja po të kisha një përkthyes.

Së fundi, po që se do ta kisha mundësinë përsëri për të zgjedhur një apartament në Prishtinë, do ta zgjidhja një banesë e cila do të ishte e pajisur me stufë me drunjë. Jo me mençuri e bëra zgjidhjen time të jetoja në një banesë me qira në tetor të vitit 2002, para se të fillonte dimri i Kosovës, pa e ditur se nuk funksiononte sistemi i nxemjes së apartamentit tim. Të gjitha ato kostume të ngrohta prej leshi që i kisha nuk bënë fare punë.

A jeni optimist se BKUK-ja do t'i mbërrijë standardet ndërkombëtare në veprimtarinë dhe shërbimet e saja? Sa mendoni se do të zgjatë ky proces?

Ekziston një gojëdhënë, e cila thotë se "për aq kohë sa ke ngecur mbrapa, aq kohë do të nevojitet që të këndellesh". Për mua kjo është një thënie shumë e vërtetë. BKUK-ja me një progres të qëndrueshëm do të arrijë atje ku dëshiron, por të kujtojmë se gjatë përparimit të BKUK-së drejt arritjes së standardeve ndërkombëtare, bibliotekat tjera do të përparojnë edhe më tej. Nuk ekziston ndonjë shkop magjik, i cili me një të prekur do ta përmbushte qëllimin e BKUK-së. Do të kalojnë vite në të tëra në përmbushjen e këtij procesi, por nëse ky përparim është i qëndrueshëm atëherë këto vite do të kalojnë shumë shpejtë.

Çfarë keni bërë në SHBA që prej gushtit të kaluar kur jeni larguar nga Kosova?

BKUK-ja ishte jeta ime për 10 muaj rresht, e cila m'i absorbonte mendimet dhe energjitë gjatë tërë asaj kohe. Edhe kur u ktheva në SHBA, jam kujdesur për përparimin e BKUK-së nga një largësi kaq e madhe prej mijëra kilometrash. Qëllimi im është që të jem i dobishëm për BKUK-në kurdo dhe në çfarëdo mënyre që të mundem, por në asnjë

mënyrë të ndërhyjë në punët e saja.

Me t'u kthyer në SHBA duhej që t'i kryeja disa punë që i kisha lënë të papërfunduara në BKUK. Këto janë: ofrimi i ndihmës (kur më është kërkuar) gjatë procesit të përkthimit dhe botimit të Planit Strategjik të Bibliotekave; identifikimi i shkollave të shkencave të bibliotekarisë, të cilat do të mund të shërbenin si modele për një program të ngjashëm në Universitetin e Prishtinës, dhe dërgimi i librave dhuratë (të cilat janë blerë prej buxhetit të njëjtë i cili më ka mundësuar qëndrimin dhe punën time në Kosovë) për fondin B të BKUK-së (literaturë profesionale e bibliotekarisë).

Gjatë qëndrimit tim në Kosovë, jam përpjekur të gjeja kohë të mjaftueshme për të lexuar materiale për Ballkanin, për shembull veprën e Noel Malkolmit (Noel Malcolm)

"Kosova: Një histori e shkurtër". Ndërsa në SHBA, duke pasur më shumë kohë për lexim, kam kaluar nga historia në letërsi, dhe kryesisht i kam lexuar romanet e Ismail Kadarese për arsye se bibliotekat të cilat i kam afër nuk ofrojnë diçka tjetër (përveç të një përmbledhjeje të përkthyer të poezive të Martin Camajit dhe Luljeta Lleshanakut dhe romanin e Ivo Andriqit "Ura mbi Drin"). Veprat e Kadarese të cilat i kam lexuar janë: "Dosja H", "Ura me tri harqe", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Një elegji për Kosovën", "Prilli i thyer" dhe "Kronikë në Gur". Natyrisht që këta tituj të përkthyer në botimet e tyre në gjuhën angleze mund ta kenë dhe mos ta kenë bartur kuptimin e plotë të shqipes gjatë përkthimit të tyre në anglisht. Kadareja në veprat e tij paraqet një vizion tragjik, kështu që megjulla, shiu, skllota, breshëri, bora ditët e ngrysura dhe netët e zymta e përshkruajnë tejet mbanë atmosferën në veprën e tij. Asnjëri prej personazheve të Kadarese nuk duket se buzëqesh, megjithatë (do të dëshiroja të përmendja) buzëqeshja zë një vend të posaçëm në kujtesën time për Kosovën dhe Shqipërinë (Slloveninë dhe Kroacinë po ashtu, sa i përket po kësaj çështje).

A dëshironi të ktheheni përsëri në Kosovë?

Po, aq sa do të më lejonin mundësitë. Jam kureshtar të shoh se sa ka përparuar dhe si po ecën përpara BKUK-ja. Po ashtu kam dëshirë të madhe t'i takoj veç e veç të gjithë ata njerëz të cilët i kam njohur, më kanë pëlqyer dhe i kam respektuar gjatë qëndrimit tim në Kosovë. Me falni që po e them këtë, por nuk do të dëshiroja ta vizitoja Kosovën gjatë periudhës së dimrit (ose përderisa klima nuk bëhet si ajo e qytetit Seattle (Sietell) ku toka është e mbuluar me gjelbërim gjatë tërë vitit). Gjithmonë jam habitur kur kam parë kosovarët të ballafaqoheshin me të ftohtit pa kapela e pa dorëza dhe zonjat duke ecur mbi taket e tyre të gjata aq të sigurta nëpër akull. Thosha me vete se Zoti me mençurinë e Tij të pafund, e ka krijuar këtë popull t'i përshtatet kësaj klime dhe besoj se edhe vetë kosovarët e shohin këtë çështje me këtë sy.

Bisedoi: Sh. Rama

Ex Libris



Alan OLIVER

Menaxher i shitjes, Ex Libris (Britani e Madhe) Ltd

Grupi Ex Libris është një kompani udhëheqëse në mbarë botën në fushën e dizajnit të softverëve për biblioteka dhe qendra të informacionit. Me mbi dy dekada të të qenit lider në fushën e bibliotekarisë dhe sistemeve të informacionit, kompania Ex Libris vazhdon të vendosë standarde bashkëkohore të prodhimeve, duke i kombinuar të mirat të cilat i ofrojnë softverët me përvojën bibliotekare me të vetmin qëllim të gjetjes së zgjidhjeve reale për t'i përmbushur nevojat gjithnjë në rritje të bibliotekave dhe qendrave të informacionit. Viti 2003 ishte një vit i suksesit për kompaninë Ex Libris dhe implementimit të produktit të saj ALEPH 500 TM në mbarë botën, pasi që ky produkt u instalua në mbi 100 vende. Viti 2004 duket të jetë i mbarë! Në qerëkun e parë të këtij viti shitja ka qenë mjaft e madhe, po ashtu, kontrata të reja janë në realizim e sipër.

Produkti i sistemit Ex-Libris ALEPH, i cili është një sistem i integruar për biblioteka është instaluar në mbi 800 qendra dhe konsorciume në më se 50 vende të botës, përfshirë Bibliotekën e Britanisë (Britani e Madhe) dhe Universitetin Harvard (Shtetet e Bashkuara të Amerikës).

VËSHTRIM MBI MODULIN E PASURIMIT TË FONDEVE TË ALEPH-IT:

Me ALEPH-in personeli i pasurimit të fondeve gëzon fleksibilitet të madh në menaxhimin e të gjitha aspekteve të procesit të porositjes dhe të pranimit të materialeve, përfshirë hulumtimin e materialeve para se të porositen, mundësinë e porositjes të të gjitha llojeve të materialeve, pranimin e faturave të materialeve të blera, si dhe veprimtaritë e tjera lidhur me bërjen e kërkesave për pasurimin e

fondeve, me buxhetin e bibliotekës dhe me komunikimin me kompanitë e shitjes. Veçoritë standarde të cilat i posedon ky modul, BISAC, SISAC dhe EDI X12, e lehtëson komunikimin tuaj me kompanitë e shitjes. Si me të gjitha modulet e ALEPH-it, edhe moduli i pasurimit të fondeve lejon që brenda një faqeje të kryhen shumë funksione. Për të lëvizur nga një funksion tek tjetri, ju thjesht klikoni në faqen ose ikonën e cila ju nevojitet, apo mund të përdorni komanda të shkurtra përmes tastierave. Dizajni dinamik i modulit të pasurimit të fondeve të ALEPH-it ju ndihmon në menaxhimin e formave komplekse të fondeve, komunikimeve me kompanitë e shitjes, porosive, faturimit dhe kërkesave me shumë lehtësi – të gjitha përmes një lidhje të thjeshtë me sistemin e jashtëm financiar të bibliotekës.

VËSHTRIM MBI MODULIN E KATALOGIMIT TË ALEPH-IT:

Modifikimi, si për tërë sistemin ashtu edhe për nevoja të posaçme, i shablloneve, formularëve, kufizimeve rutinore, si dhe forma e paraqitjes së informatave në ekran, të cilat janë nën kontrollin e plotë të mbikëqyrësve të autorizuar, janë elementet kyçe të modulit të katalogimit të ALEPH-it. Edhe pse i mbështet në të njëjtën kohë të dhënat e krijuar si në formatin MARC ashtu edhe të atyre të cilat nuk janë krijuar në këtë format, ALEPH-i krijon vetëm një bazë të të dhënave për kërkimin, katalogimin dhe përpunimin e materialeve. ALEPH-i është kompatibil me shumë forma të formatit MARC, përfshirë USMARC, UNIMARC, UKMARC, MARC21 dhe DANMARC, si dhe me formatin gjerman të katalogimit MAB. Po që se biblioteka dëshiron të krijojë të dhëna jashtë formatit MARC, atëherë, ajo mund t'i dizajnojë dhe organizojë ato sipas dëshirës që do t'iu përshtaten nevojave dhe koleksioneve të ndryshme të saja.

Katalogimi mund të bëhet në formë të organizuar ose të lirë dhe se konstrukti i saj e mundëson minimizimin e gabimeve, e përmirëson dukshëm rrjedhën e punës dhe e lehtëson të tërë procesin e katalogimit. Ky modul i lejon personelit që t'i konsultojë fajlet standarde të katalogimit, të bëjë kërkime nëpër katalogje, të kalojë me lehtësi prej një moduli në tjetrin, të importojë ose eksportojë të dhëna nga baza të tjera të të dhënave, të modifikojë të dhëna të ndryshme në të njëjtën kohë, të vëjë në përdorim kopje standarde, funksione si dhe të vëjë indeks për secilin element të fushave në të dhënat bibliografike. Menjëherë pas kompletimit të të dhënave bibliografike të një materiali, sistemi i zgjedh automatikisht elementet e fushave sipas mënyrës të cilën e ka modifikuar më parë biblioteka për t'i ruajtur ato në server. Po ashtu, edhe ndihma përmes Internetit për çdo eventualitet lidhur me katalogun është

në dispozicion të përdoruesit, dhe se biblioteka e ka nën kontrollin e vetë përbajtjen e gjithë këtij elementi të dobishëm.

VËSHTRIM MBI MODULIN E QARKULLIMIT TË ALEPH-IT:

Moduli i qarkullimit të ALEPH-it është i pajisur me një sistem fleksibil të huazimit, i cili mund të modifikohet sipas parametrave vendore të qarkullimit dhe mund të aplikohet edhe në tërë sistemin, po ashtu. ALEPH-i ju mundëson ta përcaktoni datën e vonësës së një materiali në bazë të statusit të përdoruesit, të materialit dhe lokacionit në të cilin gjendet ai material. Mund të bëni kontrollë të herëpashershme të përdoruesve të cilëve nuk iu lejohet të marrin materiale në huazim nga biblioteka, si dhe të materialeve të rezervuara me qëllim që të siguroni një menaxhim të sukseshëm të koleksioneve. Kryerja e shpejtë e veprimtarisë së qarkullimit mundësohet edhe me sistemin e integruar të arkëtimit të parave në dorë të ALEPH-it, i cili mundëson që pa vonesë personeli të informohet për gjokat dhe të mblidhë të ardhurat si prej tyre ashtu edhe prej shërbimeve të tjera me pagesë, të cilat i përcakton biblioteka. Po ashtu, ky sistem i lejon personelit të autorizuar që t'i pranojë apo edhe t'i anulojë pagesat e tilla. Përveç kësaj, sistemi siguron në mënyrë automatike gjenerimin e statistikave dhe raporteve të hollësishe, përfshirë këtu revizione të detajizuara, të cilat mundësojnë gjurmimin dhe kontrollimin e saktë të të gjitha transakcioneve të pagesave. Përdoruesit do ta çmojnë lartë funksionin e sofistikuar të huazimit ndërbibliotekar dhe të shërbimit të shpërndarjes së dokumenteve, i cili ofron me lehtësi shumë të madhe shkëmbime bilaterale të informacioneve ndërmjet bibliotekës dhe furnizuesve të dokumenteve nga e mbarë bota. Në të njëjtën kohë, moduli i qarkullimit të ALEPH-it e bën vet, në mënyrë automatike, si qarkullimin e një numri të madh materialesh ashtu edhe riorganizimin e atyre të dhënave që duhet të shfaqen në Internet.

VËSHTRIM MBI MODULIN E BOTIMEVE SERIKE TË ALEPH-IT:

Moduli i botimeve serike të ALEPH-it, i cili është i integruar tërësisht me modulën e pasurimit të fondeve, katalogimit dhe katalogut publik në Internet, i siguron personelit qasje të lehtë në të dhënat bibliografike dhe të koleksioneve, të informatave të porosive, të fondeve, të kompanive të shitjes dhe shumë e shumë të tjera. Personeli mund t'i kërkojë të dhënat për një botim serik sipas indekseve të ndryshme të cilat i përcakton biblioteka, p.sh. sipas numrit identifikues SICI, ISBN, apo edhe me një

fjalë të vetme.

ALEPH-i e mbështet tërësisht standardin MARC për të gjitha modelet e botimeve të cilat mund të njihen nga sistemi dhe po ashtu siguron mundësi të verifikimit për të gjitha botimet përveç atyre të cilat fare nuk mund të njihen nga sistemi. Baza e të dhënave të modeleve të botimeve, të cilat janë unike në sistemin Ex Libris, e lehtëson importin, eksportin dhe shkëmbimin e modeleve të të dhënave. Me t'u instaluar këto modele të botimeve, ato pastaj mund të modifikohen dhe t'u përshtaten modeleve speciale për numra të ndryshëm të botimeve serike të cilat botohen në forma të ndryshme jashtë standardeve normale, por të cilat prapë se prapë duhet të mbahen në shënim, ose për të siguruar që mos të ndodh rastësisht që sistemi të pretendojë në pasurimin e fondeve të bibliotekës me ndonjë numër të botimeve për të cilin botuesi e ka shpallur që nuk do të botohet ai më. Varësisht nga dëshira, kërkesat për pasurimin e fondeve mund të bëhen në mënyrë automatike nga vet sistemi në bazë të parametrave të përcaktuara më parë nga biblioteka, ose në mënyrë manuale.

Moduli i botimeve serike të ALEPH-it i menaxhon edhe listat rutinore të qarkullimit të materialeve brenda bibliotekës, përfshirë këtu, edhe lista të shumfishta për secilin titull veç e veç, kërkimin e njësisë që ka qarkulluar në bazë të listës rutinore si dhe mund të jep njoftime për njësinë e gjetur, kjo po që se do të nevojitej. Shërbimi i lidhjes së koleksioneve të bibliotekës dhe aftësia e qarkullimit rutinor të materialeve brenda bibliotekës janë të integruara tërësisht dhe në koordinim të plotë me menaxhmentin e qarkullimit të përgjithshëm të koleksioneve bibliotekare, të botimeve serike dhe të atij fiskal.

VËSHTRIM MBI MODULIN E KATALOGUT PUBLIK NË INTERNET TË ALEPH-IT:

Përdoruesit e të gjitha kategorive – studentët, fakultetet, anëtarët e bibliotekës nga masa e gjerë dhe hulumtuesit e ndryshëm – mund të kërkojnë dhe shfrytëzojnë katalogun publik në Internet (OPAC) të ALEPH-it përmes shfletuesve standard të Internetit dhe i gëzojnë të gjitha beneficionet që i ofron Interneti. Bibliotekat, pjesë të sistemit Ex Libris, i gëzojnë të gjitha beneficionet të një dizajni të hapur që e ofron ky sistemi, i cili u mundëson të kenë kontroll të plotë në modifikimin sipas dëshirës së tyre të dizajnit të ekranit, menyve të kërkimit, si dhe elementeve të tjera. Po ashtu, ai u mundëson atyre qasje në burime të tjera, ofron ndihmë sipas nevojës së përdoruesit përmes Internetit të cilën e ka nën kontroll të plotë vet biblioteka, si dhe shumë e shumë gjëra të tjera.

Të dhëna statistikore për bibliotekat publike në Kosovë

Bedri GASHI

Në bazë të një analize krahasuese të të dhënave të prezentuara në vjetarët statistikorë, në vitin 1977, struktura e fondeve bibliotekare të bibliotekave publike me degë, kishte shënuar një rritje pozitive. Fondi i përgjithshëm arrinte në 982.030 njësi bibliotekare, prej të cilave 544.662 në gjuhën shqipe, 422.466 në gjuhën serbokroate, 11.885 në gjuhën turke dhe 2.337 njësi në gjuhët e tjera.

Duke i krahasuar të dhënat e vitit 1975 me ato të vitit 1977, del se për çdo vit, fondi i bibliotekave publike të Kosovës është rritur për 66.111 njësi bibliotekare, ndërsa në bazë të mesatares ish-jugosllave të produksionit librar, del se në vitet '70-'75, janë shtypur 7 libra për krye të banorit, ndërsa Kosova ka stagnuar me vetëm 0.10 % të librit për krye të banorit. Të dhënat flasin qartë sesa është dëmtuar bibliotekaria kosovare në pasurimin e fondeve.

Sipas statistikave demografike, në vitin 1978, Kosova ka numëruar rreth 1.500.000 banorë, kurse të dhënat e statistikave bibliotekare, flasin për një fond prej 982.030 njësisish bibliotekare, që do të thotë se Kosova duhej të kishte edhe 517.970 njësi më shumë, në mënyrë që të plotësonte kuotën prej një libri për kokë të banorit.

Nga shfletimi i dokumentacionit arkivor kuptojmë se në vitin 1984, Kosova numëronte gjithsej 505 biblioteka të të gjitha tipeve me 628 punëtorë profesionalë. Fondin e tërësishëm të këtyre bibliotekave e përbënin 3 milionë e 677 mijë e 229 njësi bibliotekare. Ndërsa, sipas të dhënave të Shërbimit Amë (tash Departamenti i Hulumtimit dhe i Zhvillimit të Veprimtarisë Bibliotekare), pas 17 vjetësh, pra në vitin 2001, gjendja e bibliotekave në Kosovë është varfëruar tejmasë.

Gjatë vitit 2001, në Kosovë kanë punuar vetëm 340 biblioteka të tipeve të ndryshme me një fond prej 2 milionë e 58 mijë e 326 njësisish bibliotekare.

Mund të themi se pasluftës, prej 505 bibliotekash të të gjitha tipeve sa kishte Kosova në vitin 1984, aktivitetet e tyre nuk i zhvillojnë 165 biblioteka, ndërsa fondet janë varfëruar për 1 milionë e 618 mijë e 903 njësi bib-

liotekare, pa e llogaritur dëmtimin e fondit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, i cili është në revizion e sipër.

Profesionistët e bibliotekarisë mund të llogarisin përafërsisht edhe largimin dhe çregjistrimin e fondit të panevojshëm, të cilin natyrshëm e bën çdo bibliotekë me rastin e revizioneve përkatëse. Llogaritë mund të bëhen në bazë të numrit të fondeve, por nuk ka logjikë bibliotekare që mund të arsyetojë largimin e një numri kaq të madh njësisish. Me një matematikë të thjeshtë, statistikave të humbjes së pagjurmë të fondeve në gjuhën shqipe janë marramendëse.

Për dhjetë vjet me radhë, qasja jonë nëpër biblioteka ka qenë minimale dhe veprimtaria bibliotekare ka qenë e pozicionuar në duart e një minoriteti që kishte instaluar pushtetin e dhunshëm në Kosovë. Kjo strukturë e menaxhimit të dhunshëm ka shkatërruar pothuajse shumicën e fondeve bibliotekare në Kosovë.

Periudha gjatë viteve 1990-1999, ka shkëputur plotësisht bibliotekat tona nga kontinuiteti i zhvillimit të bibliotekave moderne në botë. Kështu, kjo shkëputje mund të shënohet në analet e historisë së zhvillimit të bibliotekave në Kosovë, si njëra ndër periudhat më fatkeqe të librit, dijës, shkencës dhe kulturës kosovare, në përgjithësi.

Sot, bibliotekat e Kosovës gjenden aty ku gjenden, në një stad që po hulumton mundësitë për këndellje të përgjithshme të veprimtarisë bibliotekare.

Një krahasim tjetër relevant për bibliotekat publike me degë, mund të bëhet ndërmjet viteve 1989-2002, të cilat karakterizohen me rënien e vazhdueshme të fondeve dhe largimin e tyre nga bibliotekat.



Në dy tabelat e mëposhtme jepen të dhënat krahasuese, të cilat tregojnë se në vitin 1989 bibliotekat publike numëronin 762.083 njësi bibliotekare, ndërsa degët e tyre numëronin 1.148.440 njësi bibliotekare, që gjithsej bëjnë 1.910.523 njësi, ndërsa sipas statistikave të vitit 2002, këto biblioteka numërojnë 518.626 njësi, ndërsa degët 410.822. Faktikisht, ndërmjet viteve 1989-2002, nga bibliotekat publike janë menjanuar 243.457 njësi bibliotekare, ndërsa nga degët e tyre 737.618 njësi.

	Të dhënat për vitin 1989				
	Nr. i fondëve	Nr. i lexuesve	Nr. i kushteve	Nr. i lokaleve	Sipërfaqja në m ²
Hiblioteka Publike	762083	30283	234	232	9205
Hiblioteka Degë	1148440	45254			
Gjithësi:	1910523	75537	234	232	9205
	Të dhënat për vitin 2002				
	Nr. i fondëve	Nr. i lexuesve	Nr. i kushteve	Nr. i lokaleve	Sipërfaqja në m ²
Hiblioteka Publike	518626	22912	137	170	6665
Hiblioteka Degë	410823	10554			
Gjithësi:	929449	32866	137	170	6665

Në bazë të shënimeve që shihen nga tabelat e lartshënuara, del se në krahasim me vitin 1989, në vitin 2002 ka rënë numri i lexuesve në bibliotekat publike për 7.972 lexues, ndërsa në degët e tyre për 34.986 lexues. Numri i përgjithshëm i mungesës së lexuesve arrin në 42.957 lexues.

Edhe numri i kuadrit ka pësuar rënie nga 234 në vitin

1989, në 137 në vitin 2002, që do të thotë se mungojnë 97 kuadro. Ndërsa, sa i përket numrit të lokaleve dhe hapësirës së tyre të llogaritur në metër katror, edhe këtu ka zvogëlim të ndjeshëm nga 232 lokale në 170, dhe nga 9205 m² në 6665 m², që do të thotë se mungojnë 62 lokale bibliotekash dhe 2540 m² hapësirë.



PËRFUNDIM

Në bazë të këtij hulumtimi statistikor ndërmjet viteve 1989-2002, kuptohet qartë se institucionet tona kanë trashëguar një gjendje të rëndë dhe shkatërruese të bibliotekarisë kosovare. Hapat preventivë për sanimin e kësaj gjendjeje janë më se të domosdoshëm. Bashkëveprimi dhe bashkëkoordinimi profesional e administrues janë të ndërlidhura pashmangshëm në procesin e rimëkëmbjes së bibliotekave kosovare. Domosdo, kjo shuarje kaq masive bibliotekash dhe kjo zhdukje kaq e madhe fondesh e hapësirash bibliotekare, bibliotekarinë tonë e vë para sfidave të mëdha.

LITERATURA

- Gjendja dhe problemet e bibliotekave popullore të KSA të Kosovës (raport), 1978
- Problemet aktuale të bibliotekave të KSA të Kosovës, 1978
- Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës (Raport i punës për vitin 1984), 1984
- Kuadri në bibliotekat e Kosovës, 1984
- Statisticki godishnjak za 1989, 1990, Prishtinë
- Gjendja e bibliotekave në Kosovë gjatë vitit 2001 (raport), 2001
- Vjetar statistikor për vitin 2002

JUP KASTRATI – themelues i bibliografisë moderne shqiptare

Mr. Tahir Foniqi

Prof. Jup Kastrati (1924-2003) është njëri prej studiuesve më të mirë të filologjisë shqiptare. Ai ka lënë gjurmë të thella në studimet tona filologjike. Jup Kastrati shquhet edhe si hartues i shumë teksteve bibliografike: Gjuhë, letërsi, histori e letërsisë, folklor, etnografi, etj. Ai ka hartuar vëllimet madhore bibliografike: Gjergj Kastrioti –Skënderbeu bibliografi 1454-1835, I, Tiranë, 1997 (bashkautor: Kasem Biçoku); Bibliografia e gramatikave dhe e fjalorëve të gjuhës shqipe (1496-1952); Bibliografi shqipe në gjysmën e dytë të shek. XX; Bibliografi Albanistike I, Prishtinë, 2001; Bibliografia e prof. Eqrem Çabejt 1929-1981, Prishtinë, 2003; Bibliografi e Jeronim de Radës (1831/32-1993); Bibliografi shqipe, Tiranë, 1959; Bibliografi shqipe vepra letrare e autorësh shqiptarë (1945-1958); Bibliografi e “Hostenit” (1.VIII.1945-1.VIII.1955), etj. Kontributi bibliografik i Jup Kastratit dhe “ndihmesat e tij bibliografike ngërthejnë një periudhë kohe gjysmëshekullore (1942-1992)”.¹ Rrejdhimisht, Jup Kastrati “konsiderohet autori më i besueshëm i bibliografisë shqiptare” (B. Baliu). Në këtë rrugë ai është kolos i bibliografisë.

THEMELUES I BIBLIOGRAFISË MODERNE SHQIPTARE

Interesimi i Jup Kastratit për hartimin e teksteve bibliografike, është i hershëm, që nga viti 1941. Ai, si djalosh 17 vjeçar e kishte kuptuar rëndësinë e bibliografisë, si “fillim të çdo pune kërkimore-shkencore”. Që herët ai ka shkruar: “Për dijetarin, bibliografia është një kusht i domosdoshëm...Studiuesi duhet të ketë sa më shumë informacion diturak, duhet të jetë sa më i azhuruar në specialitetin e vetë të ngushtë. Horizonti dhe diapazoni i tij vijoje të zgjerohen me anë të bibliografisë, e cila për mua është shkencë ekzakte “sui generis”. Qysh më 1970 Jup Kastrati e shtron nevojën e themelimit të Institutit të Bibliografisë në Tiranë. Prof. Jup Kastrati fillimisht njeht dhe përvetëson stan-

dardet botërore të hartimit të bibliografisë duke preferuar llojin e bibliografisë deskriptive, si pasqyrë “e gjallë e prodhimit kulturor të një kombi”. Si themelues i bibliografisë moderne shqiptare, Jup Kastrati e çmonte lart bibliografinë, si veprimtari intelektuale shkencore. Ai një herë do të shprehet kështu “... e gjithë puna bibliografike, megjithëse disiplinë e ftohtë, më dukej një poezi e vërtetë”. Jup Kastrati nuk i qaset njësisë bibliografike si një “përshkrues librash”, por si studiues i tyre. Ai përdor gjuhë të pasur shqipe dhe metodologji rigoroz shkencore. Njësitë bibliografike të tij dalin të plota e të sakta duke i parë ato vazhdimisht de visu².

LLOJET E BIBLIOGRAFIVE TË HARTUARA

Prof. Jup Kastrati, në punën e tij bibliografike, përdor disa lloje të bibliografive: speciale, kronologjike, retrospektive, personale, kritike, të autorëve, primare, të kryqëzuara, etj.

Bibliografitë speciale: Bibliografia e gramatikave dhe e fjalorëve të gjuhës shqipe (1496-1952), Bibliografi Albanistike I, Bibliografia e dramatikës (1750-1946), Bibliografia e narrativës (1846-1946), Listë e organeve të shtypit shqiptar (1848-1966), Bibliografi e “Hostenit” (1.VIII.1945-1.VIII.1955), etj.;

Bibliografitë kritike: Gjergj Kastrioti- Skënderbeu, Bibliografi 1454-1835 I, Botime për Skënderbeun në shek. XV, XVI, Shkodër, 1967;

Bibliografitë personale: Bibliografia e prof. Eqrem Çabejt 1929-1981; Bibliografi e Jeronim de Radës !1831/32-1993!; Bibliografi e Ndre Mjedës 1887-1967, Shkodër, 1967; Bibliografia e punimeve të Faik Konicës (1895-1942); Bibliografia e Migjenit (1934-1961); Bibliografi e Sterjo Spasses (1929-1961); Bibliografi e Dhimitër S. Shuteriqit, Shkodër, Qershuer, 1952; Bibliografia për Naim Frashërin (1900-1965); Bibliografia e Migjenit (1934-1961)³;

Bibliografitë kronologjike dhe retrospektive: Bibliografia e Ndre Mjedës, Eqrem Çabejt, Jeronim de Radës, Faik Konicës, Migjenit, Sterjo Spasses, Dhimitër S. Shuteriqit, etj.;

Bibliografitë anotuese: Bibliografia Botime për

Skënderbeun në shek. XV-XVI, I; Bibliografia e Jeronim de Radës, etj.; Bibliografite elementare: Bibliografia e Naim Frashërit, Ndre Mjedës, Dhimitër S. Shuteriqit, etj. Shumë tekste bibliografike të Jup Kastratit, në planin e gjerë, anojnë kah lloji i bibliografisë së kryqëzuar.

PËRFUNDIM

Jup Kastratit mund t'i bëhet vërejtje në përdorimin joadekuat të terminologjisë bibliotekare-bibliografike, bazuar në terminologjinë ndërkombëtare. Kështu, ai bibliografinë speciale e quan bibliografi tematike, por edhe të veçantë; bibliografinë deskriptive, bibliografinë përshkruese; bibliografinë personale, bibliografinë speciale; bibliografinë analitike, bibliografi të arsyetuar; bibliografinë selektive, bibliografi të përzgjedhur etj. Në anën tjetër, Jup Kastrati nuk e ndjek rendin alfabetik, germë për germë, gjatë regjistrimit të njësive bibliografike brenda viteve apo të formave të tjera bibliografike, përkatësisht anashkalon treguesit, që janë të domosdoshëm për shfrytëzuesit e teksteve bibliografike.

LITERATURA

Jup Kasrati, Bibliografia e Ndre Mjedës, Shkodër, 1967
Kasem Biçoku, Jup Kastrati, Gjergj Kastrioti- Skënderbeu, Bibliografi 1454-1835 I, Tiranë, 1997
Prof. Dr. Jup Kastrati, Bibliografi Albanistike I, Prishtinë,

2001

Begzad Baliu, Arkivi i madh i qytetërimit shqiptar. Ars, 28 shtator 2003

Begzad Baliu, Vepra bibliografike e Prof. Dr. Jup Kastratit (dorëshkrim)

Bibliotekarski leksion, Beograd, 1984

Tahir Foniqi, Tema nga bibliotekari, Prishtinë, 2003

- 1 *Mira Sykja, Studimet bibliografike të prof. dr. Jup Kastratit. Prof. Dr. Jup Kastrati, Bibliografi Albanistike I, Prishtinë, 2001, f. 18.*
- 2 *De visu (lat.), me shikim në burim. Për Jup Kastratin, si bibliograf, kanë shkruar me respekt shumë intelektualë shqiptarë e të huaj: Vehbi Bala, Dritëro Agolli, Mentor Quku, N. Lazari, Mahir Domi, Mira Sykja, Eqrem Çabej, Ernest Koliqi, Vili Kamsi, Begzad Baliu, V. Pissani, Gerhard Teicll, Robert Schëanke etj.*
- 3 *Jup Kastrati ka hartuar edhe dhjetëra bibliografi personale për autorë shqiptarë e të huaj: Kolë Kamsi, Aleksandër Xhuvani, Mahir Domi, Shaban Demiraj, Jordan Misja, Gjon Buzuku, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Ibrahim Nezim Frakulla, Nikollë Keta, Naum Veçilharxhi, Daut Boriçi, Dhimitër Kamarda, Francesko Solana, Arnold von Harfi, Gottfried Wilhelm Leibniz, Francesko Maria de Lecce, Johann Erich Thumann, Norbert Jokli, Maximilian Lambertz, Carli Taglavini, etj.*


DANIMARKË

BKUK-ja u anëtarësua në Lidhjen e Bibliotekave Hulumtuese të Evropës (LIBER)

BKUK-ja është anëtarësuar në Lidhjen e Bibliotekave Hulumtuese të Evropës (LIBER), në të cilën bëjnë pjesë Bibliotekat Kombëtare dhe ato Universitare të pothuajse shumicës së vendeve të Evropës. Anëtarësimi në këtë asociacion është pjesë e programit OCLC/PICA, sipas të cilit BKUK-ja do të jetë e liru nga pagesa e anëtarësisë për tri vitet e ardhshme (2004-2007), duke filluar nga 1 janari i këtij viti.

Lidhja e Bibliotekave Hulumtuese të Evropës (LIBER) është asociacioni kryesor i bibliotekave hulumtuese në Evropë. Ajo është themeluar më 1971 me përkrahjen e Këshillit të Evropës. Aktualisht, ajo përfshin bibliotekat hulumtuese të më shumë se tridhjetë vendeve. LIBER

promovon bashkëpunimin ndër-bibliotekar në tërë Evropën. Aktiviteti i saj është i ndërlidhur me programet për zhvillim të Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian, IFLA-s, etj. Evropës Aktiviteti i LIBER-it është i lidhur me Programet për Zhvillim të Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian, IFLA, etj. Anëtarësimi në LIBER është dëshmi e shtrirjes së bashkëpunimit të BKUK-së me organizatat dhe asociacionet ndërkombëtare dhe me bibliotekat kombëtare dhe universitare të Evropës.



Botimet elektronike

Botimet elektronike mbulojnë një fushë me zhvillim të shpejtë të botimeve që kërkojnë përdorimin e kompjuterit për qasje të informacionet që përmbajnë. Ato mund të jenë dokumente të shpërndara falas apo që merren përmes blerjes. Furnizimi me to bëhet në dy forma – botimet jashtë internetit dhe botimet në internet. Disa botime elektronike nuk mund të bartën përmes bartësve fizikë dhe duhet të kopjohen nga sisteme qasësh bibliotekare dhe të arkivohen në hard-disque, strimerë cd, apo sisteme të tjera të arkivimit të të dhënave. Të tjerat barten nga bartës fizikë dhe mund të arkivohen nëpër raftë. Prandaj, ky kapitull nuk do të merret me bartës fizikë – kjo mund të bëhet në kapitujt e ardhshëm – por me çështje specifike të nxjerrjes, përzgjedhjes, arkivimit dhe të qasjes së këtij grupi dokumentesh.

BOTIMET JASHTË INTERNETIT

Një botim jashtë internetit është dokument elektronik, i cili është bibliografikisht i identifikueshëm, që arkivohet në një formë të ledueshme mekanike në një medium arkiviimi elektronik. CD-ROM, disketa apo disqet dhe shiritat mangetikë janë disa shembuj të kësaj.

– Mongografite jashtë internetit, p.sh. një enciklopedi në CD-ROM.

– Serial jashtë internetit, p.sh. një revistë në CD-ROM.

BOTIMET PËRMES INTERNETIT

Një botim (apo resurs) në internet është ai dokument elektronik, i cili është bibliografikisht i identifikueshëm, i arkivuar në formë të lexueshme mekanike në një medium elektronik arkivimi dhe që ka qasje në internet. Për shembull, një revistë (zhurnal) elektronik, një ueb-faqe botërore, apo një bazë interneti e të dhënave.

– Monografi interneti, p.sh. një fjalor në ueb.

– Serial interneti, p.sh. gazetë a revistë elektronike në ueb.

– Një burim interneti, p.sh. një ueb-faqe e ndonjë organizate.

Botimet elektronike mund të jenë botime origjinale elektronike, por mund të jenë edhe versione të digjitalizuara të një dokumenti të shkruar apo të shtypur. Për shumë përmbledhje, shumica e publikimeve elektronike do të jenë versione të digjitalizuara të ndonjë dokumenti të shkruar apo të shtypur që kanë në posedim. Shembuj do të ishin CD-ROM-i i Bibliotekës Kombëtare në Pragë, që përmban disa dorëshkrime dhe dokumente të tjera, Projekti i Shën Sofisë nga Bullgaria, Radziwill Chronicle,

Dorëshkrimet e Sana-s dhe Memoria de Iberoamerica. Prodhuesit dhe botuesit e publikimeve elektronike mund të jenë botues tradicionalë që zgjerohen në fusha të reja të botimeve. Mund të jenë edhe provajderë të themeluar rishtas të përmbajtjeve të reja, sidomos në rastin e botimeve të reja në ueb-faqen botërore www (World Wide Web) të cilët ofrojnë vetëm publikime elektronike në internet. Pos kësaj, disa kompani specializohen në publikime CD-ROM-i.

Aktualisht, shumica e publikimeve shkruhen, redaktohen dhe formatizohen duke përdorur procesorë dhe softuer publikimesh desktopi. Versioni i shtypur i gazetës apo monografisë rrjedh nga forma elektronike.

DALLIMI MIDIS MATERIALIT AUDIO-VIZUEL DHE PUBLIKIMIT ELEKTRONIK

Aktualisht bëhen publikime multimediale që përbëjnë një përzierje materialesh, p.sh. biografi, bibliografi, poza (fotografi), animacion, video dhe audio. Nganjëherë është vështirë të bëhet dallimi midis një dokumenti audio-vizuel dhe një publikimi elektronik që ka të bëjë me tekstin. Për shembull, një film me titrim është audio-vizuel – një CD e Majkell Xheksonit me një video-klip që përbëhet nga imazhe lëvizëse konsiderohet audio CD. Një CD-ROM që përmban një biografi, një bibliografi, tekste dhe këngë, pak ton, video dhe fotose konsiderohet publikim multimedial CD-ROM.

Me një fjalë, publikimet elektronike duhet të përmbajnë një sasi të konsiderueshme të tekstit para se atë ta marrë ndonjë bibliotekë për depozitim. Disa biblioteka marrin edhe publikime audio-vizuele për depozitim, p.sh. Biblioteka Gjermane në Frankfurt të Gjermanisë.

DOKUMENTET ELEKTRONIKE APO INFORMACIONI VIRTUAL

Termi dokumente elektronike apo, siç quhen nganjëherë, informacioni virtuali, ka të bëjë me metodat moderne të transmetimit të dokumenteve mes individëve, para së gjithash të dokumenteve me bazë tekstuale – ekuivalente të letrave dhe memorandumëve – me mjete elektronike, dmth. pa përdorim të letrës. Shumë nga problemet aktuale dhe potenciale të krijuara nga dokumentet elektronike janë të ngjashme me ato që krijohen nga publikime elektronike.

Dokumentet, përderisa arkivohen diku në ndonjë bartës fizik dhe me qasje të lehtë për një grup të vogël njerëzish,



përfshirë edhe autorin, megjithëkëtë, për një arkivist vëshirë hapen dhe ruhen. Dokumentet përfshijnë mesazhe e-maili dhe dosje kompjuterike të ruajtura në kompjuterë personalë. Kur dokumentet elektronike të jenë arkivuar, kjo bëhet në bartës fizikë që përdorin lloje të tjera dokumentesh. Faktori kryesor që bën dallimin e dokumenteve elektronike nga dokumente të tjera është metoda e bartjes.

Problemi i parë dhe madhor në ruajtjen e dokumenteve elektronike është që të ketë qasje deri tek ato dhe që të zbulohet se çfarë ka. Kjo mund të bëhet vetëm me mbështetjen aktive të institucionit dhe stafit të tij. Nëse institucioni ka një rrjet PC-je, problemi i qasjes mund të lehtësohet.

Pasi që shumë nga mesazhet e e-mailit midis stafit kanë gjasë të jenë triviale dhe, mbase, paksa intime nëse lexohen nga të tjerët, pos autorit dhe marrësit të caktuar, është esenciale të ketë siguri që secili të jetë i vetëdijshëm se arkiva do të vëzhgojë kohë pas kohe si dosjet formale, ashtu dhe mesazhet që përmbahen në serverin qendror të dosjeve (files) për të përzgjedhur materialin që e vlen të ruhet.

Porsa të jetë marrë qasja, materiali mund t'i shtrohet kriterit standard të përzgjedhjes dhe informacioni i zgjedhur mund të kopjohet në sistemin e arkivimit të të dhënave. Ruajtja afatgjate e informacionit pastaj mund të jetë pjesë e strategjisë së dokumenteve në përgjithësi.

PËRZGJEDHJA

Shumë arkiva dhe biblioteka janë duke bërë hulumtime për metodat më të mira për të ofruar qasje të materi-

aleve elektronike në periudha shumë afatgjate. Pikërisht për shkak të sasisë së materialit të prodhuar, posaçërisht përmes Uebit Gjithëbotëror (World Wide Web - www), përzgjedhja është esenciale. Shumë arkiva dhe biblioteka përdorin kriterin ekzistues të përzgjedhjes për materiale të shtypura edhe për materiale elektronike. Përmbajtjet e dokumentit janë faktorë relevantë për seleksionim dhe jo mediumi. Kjo do të thotë se bartësi fizik, hardueri dhe softueri i përdorur nuk janë relevantë për procesin e përzgjedhjes. Kriteret e përzgjedhjes janë të definuara me politikë lokale, p.sh. në Gjermani, materiali audio-vizuel është i përfshirë në bibliografinë kombëtare, në disa vende të tjera, ai nuk është.

NXJERRJA DHE REGJISTRIMI

Publikimet jashtë internetit mund të arrijnë shpesh në bibliotekë si publikime të shtypura. S'do mend, kur bibliotekat zënë të grumbullojnë publikime jashtë Internetit, për këtë duhet të njoftohen botuesit. Në Holandë, ku depozitimi bëhet në mënyrë vullnetare, është me rëndësi që botuesit të jenë të informuar lidhur me kriterin e ri të përzgjedhjes. Në Francë, ligji përcakton se cilat publikime duhet të dorëzohen.

Publikimet në internet kërkojnë një formë të re bashkëpunimi. Publikimi duhet të bartet nga sistemi amë (host) në bibliotekë, përmes rrjetit. Dokumentet e seleksionuara ose merren me porosi, barten automatikisht nga ana e botuesit, ose nxirren nga biblioteka përmes aplikimit të haresterit. Për dokumente interneti, me nxjerrje nënkuptohet migracioni fizik (përmes rrjetit) të dokumentit nga sistemi-host në sistemin depozitues. Botuesi/prodhuesi i dokumentit apo administratori (për arkiva) duhet të jetë i involvuar në këtë proces.

Është e domosdoshme që dokumentet që merren nga biblioteka të regjistrohen. Kjo kërkon një këmbim të informacionit bibliografik (informacion para-publikues) midis bibliotekës depozituese dhe botuesit (për arkiva kjo do të jetë midis institucionit qeveritar dhe arkivës), është e preferueshme para marrjes. Regjistrimi i dokumenteve që arrijnë duhet aktivizuar me të arrirë.

INSTALIMI

Është e domosdoshme që instalohet publikimi elektronik që të mund të shikohet dhe të përshkruhet nga bibliotekari. Për dokumente në internet kërkohet që të bëhet lidhja me sistemin host; dokumentet jashtë internetit duhet të instalohen fizikisht në stacionin e punës.

[/ vijon në numrin e ardhshëm /](#)

Manifesti i IFLA-s për Internetin

Qasja e papenguar ndaj informacionit është esenciale për lirinë, barazinë, mirëkuptimin dhe paqen globale. Prandaj, Federata Ndërkombëtare e Asociacioneve Bibliotekare (IFLA) konfirmon se:

Liria intelektuale është e drejtë e çdo individi për të mbajtur dhe shprehur mendimet dhe për të kërkuar e për të marrë informacion; dhe kjo është në thelbin e shërbimit bibliotekar.

Liria e qasjes ndaj informacionit, pa marrë parasysh mediumin dhe kufijtë, është përgjegjësi qendrore e bibliotekës dhe profesionit informativ.

Provizioni i qasjes së papenguar në internet nga ana e bibliotekave dhe shërbimeve të informacionit mbështetë komunitetet dhe individët për të arritur lirinë, prosperitetin dhe zhvillimin.

Barrierat ndaj rrjedhës së informacionit duhet hequr; sidomos ato që promovojnë pabarazi, varfëri dhe dëshprim.

LIRIA E QASJES NDAJ INFORMACIONIT, INTERNETIT DHE BIBLIOTEKAVE E SHËRBIMEVE TË INFORMACIONIT

Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit janë institucione të gjalla që lidhin njerëzit me burime globale informacioni dhe me idetë dhe punën krijuese që kërkojnë ato. Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit ofrojnë begatinë e shprehjes njerëzore dhe diversitetin kulturor në të gjitha mediat.

Interneti global u mundëson individëve dhe komuniteteve anëmbanë botës, qofshin ato edhe në fshatrat më të vegjël dhe më të largët apo qytetet më të mëdha, për të pasur qasje të barabartë të informacionit për zhvillimin, edukimin, stimulimin, pasurimin kulturor, veprimtarinë ekonomike të individit dhe pjesëmarrjen e informuar në demokraci. Të gjithë mund t'i paraqesin interesat e tyre, njohuritë dhe kulturën para tërë botës. Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit ofrojnë porta esenciale të Internetit. Për disa ato ofrojnë lehtësi, udhëzim dhe asistencë, derisa për të tjerët ato janë pikat e vetme të mundshme të qasjes. Ato ofrojnë një mekanizëm për të kapërcyer barrierat e dallimeve në resurse, teknologji dhe trainim.

PARIMET E LIRISË SË QASJES NDAJ INFORMACIONIT PËRMES INTERNETIT

Qasja në Internet dhe të gjitha resurset e tij duhet të jenë në pajtim me Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut, posaçërisht të Nenit 19:

Secili ka të drejtë për liri mendimi dhe shprehje; kjo e drejtë përfshin edhe lirinë për të mbajtur opinione pa ndërhyrje dhe për të kërkuar; pranuar dhe për të dhënë informacion dhe ide përmes medias pa marrë parasysh kufijtë.

Ndërlidhshmëria globale e Internetit ofron një medium përmes të cilit kjo e drejtë mund të gëzohet nga të gjithë.

Rrjedhimisht, qasja nuk duhet t'i shtrohet as ndonjë forme të

censurës ideologjike, politike a religjioze, e as barrierave ekonomike.

Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit kanë gjithashtu përgjegjësi për t'u shërbyer të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve të tyre, pa marrë parasysh moshën, racën, kombësinë, religjionin, kulturën, përkatësinë politike, të metat fizike apo të tjera, gjininë apo orinetimin seksual, apo çfarëdo statusi tjetër. Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit duhet të mbështesin të drjtën e shfrytëzuesve për të kërkuar informacionin e zgjedhjes së tyre.

Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit duhet të respektojnë intimitetin e shfrytëzuesve të tyre dhe të njohin faktin se resurset që i përdorin ata duhet të mbeten konfidenciale.

Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit kanë përgjegjësi për të siguruar dhe promovuar qasjen publike ndaj informacionit dhe komunikimit cilësor. Shfrytëzuesit duhet asistuar me aftësitë e domosdoshme dhe me një mjedis të përshtatshëm në të cilin do të përdorin burimet dhe shërbimet e zgjedhura të informacionit në mënyrë të lirë dhe konfidenciale.

Përpos shumë resurseve të vlefshme që ofron Interneti, disa janë jokorrekte, mashtruese dhe mund të jenë fyese. Bibliotekarët duhet të ofrojnë atë informacion dhe burime për shfrytëzuesit e bibliotekave për t'i mësuar se si duhet përdorur Internetin dhe informacionin elektronik në mënyrë efikase dhe efektive. Ata duhet të promovojnë dhe të ofrojnë proaktivisht qasje me përgjegjësi ndaj informacionit të rrjetëzuar cilësor për të gjithë shfrytëzuesit, përfshirë fëmijët dhe të rinjtë.

Bashkërisht me të gjitha shërbimet elementare, qasja në Internet në biblioteka dhe shërbimet e informacionit duhet të jetë falas.

IMPLEMENTIMI I MANIFESTIT

IFLA inkurajon bashkësinë ndërkombëtare të mbështesë zhvillimin e qasjes përmes Internetit anëmbanë botës, posaçërisht në vendet në zhvillim, për të arritur kështu përparësitë globale të informacionit për të të gjithë atyre që u ofrohet përmes Internetit.

IFLA inkurajon qeveritë kombëtare për të krijuar një infrastrukturë kombëtare të informacionit, e cila do të ofrojë qasje Interneti për tërë popullsinë e një vendi.

IFLA inkurajon të gjitha qeveritë që të mbështesin rrjedhën e papenguar të qasjes së informacionit përmes Internetit, përmes bibliotekave dhe shërbimeve të informacionit dhe që t'i kundërvihen çfarëdo përpjekjeje për të censuruar dhe penguar qasjen.

IFLA inkurajon komunitetin bibliotekar dhe vendimmarrësit në nivele kombëtare dhe lokale të zhvillojnë strategji, politika dhe plane që implementojnë parimet e shprehura në këtë Manifest.

Ky Manifest u përgatit nga IFLA/FAIFE

LIGJI PËR BIBLIOTEKAT

NENI 22

Biblioteka Kombëtare e Kosovës

22.1. Biblioteka Kombëtare e Kosovës është institucioni bibliotekar qendror i Kosovës, dhe qendër informacionit bibliotekar në nivel kombëtar.

22.1.a. Biblioteka Kombëtare e Kosovës themelohet me vendim të Kuvendit të Kosovës.

22.2. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës është nën autoritetin e Ministrisë së Kulturës;

22.3. Biblioteka Kombëtare e Kosovës:

22.3.1. është qendër e marrjes dhe e depozitimit të kopjes së detyrueshme;

22.3.2. është qendër e krijimit dhe e mirëmbajtjes së katalogut përmbljedhës kombëtar, respektivisht të bazës përmbljedhëse kombëtare të të dhënave;

22.3.3. është qendër e studimeve në fushën e bibliotekonomisë, bibliografisë dhe të informacionit;

22.3.4. është qendër e përgatitjes dhe e ofrimit të informacionit bibliografik, bartëse e kontrollit bibliografik në bibliotekat e tjera dhe botuese e bibliografisë kombëtare;

22.3.5. është qendër metodike për zbatimin e standardeve dhe të rekomandimeve të organizatave dhe organizmave përkatës ndërkombëtar në veprimtarinë bibliotekare dhe të informacionit bibliotekar;

22.3.6. është qendër për restaurimin dhe konservimin e librit;

22.3.7. është qendër për koordinimin e rrjetit kombëtar bibliotekar;

22.3.8. vepron si qendër e huazimit ndërbibliotekar;

22.3.9. katalogon publikacionin e përgatitur për botim (CIP) dhe bën pajisjen e publikacioneve me

numrat standard ndërkombëtarë (ISBN dhe ISMN) të botuesve në Kosovë;

22.3.10. Zhvillon programe për trajnimin dhe aftësimin profesional e të vazhdueshëm të punonjësve bibliotekar;

22.3.11. plotëson shërbimet e bibliotekave ndërkomunale dhe të Bibliotekës Universitare ;

22.3.12. ushtron mbikëqyrjen profesionale ndaj të gjitha bibliotekave;

22.4. Biblioteka Kombëtare e Kosovës anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare dhe merr pjesë në aktivitete bibliotekare ndërkombëtare.

22.4.1 Selia e Bibliotekës Kombëtare është në Prishtinë.

NENI 25

Biblioteka Universitare

25.1. Biblioteka Universitare është bibliotekë qendrore e Universitetit të Prishtinës.

25.2. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës Universitare është nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit në bashkëpunim me Universitetin.

25.3. Biblioteka Universitare siguron materiale, informacione dhe shërbime bibliotekare që ndihmojnë veprimtarinë akademike e shkencore si dhe procesin e edukimit shkencor e artistik në Universitet dhe zhvillimin e aftësive të studentëve dhe mësimeve të tyre;

25.4. Ndihmon studentët që ndjekin studimet në distancë duke iu dhënë në huazim materiale bibliotekare dhe duke siguruar qasje në burimet elektronike të informacionit.

25.5. Plotëson shërbimet e bibliotekave të fakulteteve në përbërjen e Universitetit.

25.6. Selia e Bibliotekës së Universitetit është në Prishtinë.

Programi i automatizimit të BKUK-së

-Faza përgatitore-

BKUK është duke u përgatitur për implementimin e programit të automatizimit të BKUK-së. Projekti ka për qëllim: përgatitjen e BKUK-së për implementimin e programit të automatizimit gjatë vitit 2004;

pajisjen e bibliotekës me teknologji moderne, e cila do të jetë në shërbim të implementuesit të programit, trajnimin profesional të punëtorëve të BKUK-së për implementimin dhe zbatimin praktik të mundësive që i ofron programi; njohjen me funksionimin e programit në Bibliotekat Kombëtare të Evropës. njohjen me resurset njerëzore (përmes trajnimeve) të përshtatshme për implementimin e programit.



Aktivitetet:

Faza e parë, përgatitore, e implementimit të programit nënkupton:

- pajisjen me teknologji bashkëkohore (kompjuterë, printerë...) të Departamentit të Shërbimeve Kopjuterike;
- trajnimet e stafit të bibliotekës, të cilët duhet të jenë të ndërlidhur praktikisht në implementimin e programit. Ky trajnim do të rezultojë me një raport të detajuar lidhur me resurset njerëzore, si dhe me aftësitë e tyre në përdorimin e teknologjisë moderne informatike. Pasqyra e përfutur do të shërbejë për shpërndarjen e përgjegjësive gjatë fazës së implementimit.

Faza e dytë e përgatitjes për implementimin e programit nënkupton:

- Hartimin e skemës së vendeve të nevojshme të cilat duhet të mbulohen me resurse njerëzore dhe me teknologji bashkëkohore. Për këtë qëllim do të merren parasysh disa faktorë:
 - Numri i licencave të lejuara nga implementuesi i programit;
 - Shtrirja hroizontale dhe vertikale e vendeve të cilat duhet të mbulohen (për këtë qëllim duhet të shfrytëzohet përvoja e përfutur nga vizita në njërën nga Bibliotekat Kombëtare të Evropës)
 - rezultatet e trajnimeve gjatë kursit të kompjuterëve, si dhe

- njohuritë profesionale të punëtorëve të cilët do të marrin licencën për implementimin e çdonjërit nga segmenet e programit

Vërejtje: Pika C dhe D duhet të koordinohen me qëllim përfitim.

- resurset njerëzore (emrat e punonjësve dhe shpërndarja e tyre). Faza përfundimtare e përgatitjeve duhet të rezultojë me krijimin e vizionit për përdorimin e licencave që do të aplikohen, si dhe e skemës hipotetike të resurseve njerëzore për implementimin e programit.

Koha : Meqë programi pritet të implementohet në prill-qershor të vitit 2004, faza e parë e periudhës përgatitore duhet të kryhet gjatë muajit shkurt, kurse faza e dytë gjatë muajit mars dhe në fillim të muajit prill të vitit 2004.

Rezultati i pritur: Faza përgatitore, si gjithkund e gjithëherë, synon të jetë pjesë e projektit për implementimin e programit të automatizimit. Ajo duhet të përgatisë stafin udhëheqës dhe punëtorët e BKUK-së për fazën finale të projektit, implementimin e programit. Ajo i paraprin dhe e përgatit stafin e saj për implementim të sigurt të programit, i zbulon kapacitetet njerëzore të gatshme për teknologjitë e reja, si dhe i parashtron kërkesat paraprake për fazën finale të projektit.

NGJARJE NDËRKOMBËTARE

BERLIN

Hartmut Walravens, drejtor i Agjencisë Ndërkombëtare të Numrit Muzikor, me përfaqësues të BKUK-së, Agjencinë e ISBN-së për Kosovë, nënshkruan kontratën lidhur me anëtarësimin e BKUK-së në Agjencinë Ndërkombëtare të ISMN-së, me qëllim që BKUK-ja të jetë bartëse apo shpërndarëse e numrave të ISMN-së për Kosovë. E veçantë e kësaj agjencie është se çdo muzike të shtypur në Kosovë, përkatësisht të botuar në Kosovë, do t'i caktohet dhe t'i vendoset numri standard, i cili do t'i përgjigjet sistemit të kontrollit ndërkombëtar nga Agjencia e ISMN-së.

ZAGREB

Historiani dhe studiuesi shqiptar, dr. Musa Ahmeti, gjatë hulumtimeve të tij në fushë të historisë dhe gjuhësisë që kanë të bëjnë me dhe për shqiptarët, në Zagreb, pas zbulimit të dorëshkrimit të Teodor Shkodranit, nga Zagrebi solli në BKUK disa dorëshkrime të panjohura deri më tani. Dorëshkrimet e dhuruara janë fryt i një pune hulumtuese kërkimore dhe shkencore, në sektorin e dorëshkrimeve dhe librit të rrallë në Bibliotekën Shkencore të Dubrovnikut.

LONDËR

Alan Oliver, ekspert anglez i Ex-Libris-it -kompani me renome botëror në fushën e sistemit të automatizimit bibliotekar-, në shtator të vitit 2003, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, mbajti ligjëratë në Sesionin Konsultativ : Sistemet moderne dhe automatizimi i bibliotekave. Sipas Oliverit, Produkti i Ex-Librisit - Aleph 500, edhe në këtë milenium mbetet sistemi kryesor dhe më i avancuari në fushën e bibliotekarisë. Objektivi i këtij sesioni

ishte lehtësimi i ndarjes së përvojës së pjesëmarrësve në diskutimin e çështjeve komplekse, për të nxjerrë mësim të mjaftueshme dhe më pas të hartohet strategjia e përbashkët për një qëndrim serioz në procesin e automatizimit të bibliotekave.

DRESDEN

Një nismë e re partneriteti midis Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekës Shtetërore dhe Universitare të Dresdenit, u inicua në takimin që pati delegacioni i BKUK-së në Dresden të Gjermanisë. Në këtë vizitë, qëllim parësor ishte vëzhgimi i reformave transformuese të sistemit bibliotekar në vendet në zhvillim, dhe i ngritjes së kapaciteteve bibliotekare, siç ishte modeli i Bibliotekës Shtetërore dhe Universitare të Dresdenit.

POLONI

Në Varshavë u nënshkrua marrëveshja për bashkëpunim ndërmjet Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekës Kombëtare të Polonisë. Kjo vizitë u konsiderua vetëm fillim i procesit të bashkëpunimit, prandaj edhe priten zhvillimet e mëtejshme në këtë drejtim. Një hap tutje e mori këto ditë BKUK-ja e cila sipas marrëveshjes, gjegjësisht pikës tre të bashkëpunimit për shkëmbime bibliotekare të literaturës Polonica-Albanica, i dërgoi Bibliotekës Kombëtare të Polonisë një kontigjent materialesh kryesisht letërsi polake, e botuar në Kosovë.

SAKSONI E ULËT –GJERMANI

Delegacioni i Parlamentit të Sanksonisë së Ulët-Gjermani, vizitoi Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Në këtë

takim u bisedua për marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy vendeve, Kosovës dhe Gjermanisë, me ç'rast ky i fundit e cilësoi të domosdoshëm bashkëpunimin dhe premtoi një të ardhme me shkëmbime përvojash në fushën e kulturës dhe shkencës.

SHQIPËRI

Rifillon bashkëpunimi ndërmjet Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, me përrurimin e donacionit prej 5460 librash, të nxjerra nga fondi rezervë dhe i shkëmbimit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Dr. Aurel Plasari, drejtor i BKS-së, me këtë rast vlerësoi se libri mbetet sfida e kohës, e teknologjive të përparuara, e internetit, kibernetikës, dhe e njerëzve që mendojnë se libri është gur themeltar i kulturës. Sipas tij, këto 100 vitet e fundit ka qenë libri dhe autorët e tij bërësit kryesorë të shteteve të Ballkanit, pra edhe të Prishtinës.

STAMBOLL-TURQI:

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës që nga tetori i vitit 2002, inkuadrohet në rrjetin eIFL directory (electronic Information for Libraries). Nga takimi i punës së eIFL-së, koordinatorëve të vendeve të Evropës, mbajtur në Stamboll të Turqisë, mori pjesë edhe përfaqësuesi nga Kosova i eIFL-it. Në këtë takim Arnold Hirshon –drejtor i NELINET, SHBA, diskutoi këto tema: Analizimi i koleksioneve; Menaxhimi i burimeve elektronike; Integrimi në burimet elektronike; Licensimi i burimeve elektronike. Ndërsa Frederick J. Friend nga Anglia diskutoi temën: Bisedimet me prodhuesit e burimeve elektronike.

"BIBLIOTHECAE 3"

Një material me ineteres të posaçëm në nivelin e bibliotekarisë është "Biblioteka 3" si organ i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, që në numrin e vitit 2002 botoi një sërë informacionesh , ngjarjesh e deklaratash me vlerë të cilat i kalojnë kërkesat kombëtare. Si tekst i strukturuar në gjithsej 10 pjesë, fillon me informacionet historike të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, ngjarjet që e përcollën nga më të ndryshmet duke pasur si pasojë jo vetëm pasurimin po shpesh edhe varfërimin e fondeve të saj. Një fillim historik tek "Biblioteka e Komosis Letrare", më 16 prill 1917, të Shkodrës si fazë parakombëtare e saj, e deri në ditët e sotme. Pas përshkrimeve historike të bibliotekës dhe fytyrave të ndritura të bibliotekarisë shqiptare si të M. Domit, K. Gurakuqi, etj., jipen shkurtimisht edhe ca informacione për rëndësinë e përgjithshme të bibliotekës, si: funksioni i grumbullimit të librave, ruajtjes, kujdesit, mirëmbajtjes dhe ofrimit të mundësisë për lexuesit që të komunikojë me të. Në këtë botim kemi shkrime të autorëve të ndryshëm vendës e të huaj, një mënyrë gërshetimi e tillë që shton diapazonin e problemeve dhe cilësinë e tyre. Si e tillë jo njëherë shtron probleme më moderne nga programe të dryshme kompjuteristike në komunikimin libër-lexues. Në këtë nivel paraqiten programe të ndryshmet si ai i UNIMARC-it që lehtëson punën e katalogimit të librave dhe zgjeron mundësitë e formave të dryshme të kërkimit të librave nga lexuesit.



NDRYSHIMET SI PËRPPJEKJE PËR PËRMIRËSIME

Kohëve të fundit një rëndësi e posaçme në zhvillimet më të reja të bibliotekarisë iu është kushtuar ndryshimeve në të mirë të punëve të bibliotekës dhe stafit mbrenda bibliotekës. Libri " Menaxhimi i ndryshimeve në shërbimet bibliotekare dhe informuese " (Korfuz 2001), i zëvendësdrojtores së Bibliotekës së Universitetit të Bristolit, Cathryn Gallacher, është një ndër ata të rrallët që merret me këtë tematikë ku shihen pretendime gjithherë të ngritjes së cilësisë të këtyre punëve. Në të paraqiten gjithashtu edhe faktorët e ndryshëm konfrontues që e stopojnë dhe ata që e avancojnë ndryshimin, duke sjellë shembuj nga më të ndryshmet se si të tejkalohen ata stopues. Është një pretendim që përmes përkthimeve të plotësohet kërkesa e lexuesve në nivele të ndryshme. Libri pretendon ta ngrisë



vetëdijen e lexuesve profesionistë për nevojën e gjithhershme të ndryshimeve të këtitla.

ADMINISTRIMI I BIBLIOTEKËS

Libri "Udhëzues administrimi për bibliotekat universitare " (Korfuz 2001), vazhdon punën e përparimit bibliotekar e ndërbibliotekar që ia ka qitur përpara tërësia e teksteve me temat e bibliotekarisë. I strukturuar në 3 pjesë që përfshijnë shtjellime të problemeve të rrafsheve të ndryshme libri zgjerohet me shembuj , këshilla e forma të ndryshme për kuptimin më të mirë duke i dhënë karakterin pragmatik. Libri prek pikat kryesore të cilave duhet t`u kushtohet më shumë rëndësi dhe pa të cilat nuk mund të mbijetojë një bibliotekë në një gjendje normale. Këtu bëjnë pjesë: shpenzimet në blerjen e librave, pasurimin e fondeve të veçanta , përmes të cilave shtohet numri sasior në rrafshe të ndryshme të librave , shpenzimet në botimin e librave të bibliotekës që ndahen në dy grupe: në botime profesionale dhe në botime informative, etj. Në pjesën e dytë kryesisht trajtohet vlerësimi si një dukuri që ngrit nivelin e punës përgjithsisht në bibliotekë. Në libër paraqiten edhe bazat e vlerësimit apo referencat ku bëhen për t`u vlerësuar veprimi i tashëm ku numërohen ato të përvojës së kaluar, të zhvillimeve ndërkombëtare dhe vendore në nivelin e teknologjisë, të metodologjive të ndryshme profesionale e joprofesionale ,etj., ku arrin që ta ngrisë dhe lehtësojë punën e stafit bibliotekar. Pjesa e tretë e këtij libri paraqet kryesisht komunikimet në mes të bibliotekave, komunikim të cilin e realizojnë përmes shkëmbimeve të librave. Këto janë disa karakteristika që e shquajnë këtë libër që realizon një punë të suksesshme për pjesën e administrimit në bibliotekë.



KATALOGIMI MË MODERN

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë ka evoluar në pikëpamje të botimit të librave për ngritjen profesionale të punëtorëve të saj. Në mesin e librave për kursistët, është edhe libri i botuar dy vite më parë " Përshkrimi bibliografik i materialeve bibliotekare " (Korfuz-Tiranë 2001). Libri në përgjithësi mbështetet në standardet ndërkombëtare, duke gërshetuar përvoja të ndryshme të vendeve të ndryshme. Këtu paraqiten kryesisht shtjellime të rregullave për punët që qarkullojnë në bibliotekë, si rregullat e katalogimit të materialeve bibliotekare mbi bazën e ISBD-së dhe të rregullave anglo-amerikane, AARS2, në mënyrë të imtë, madje deri në nivelet e mikrostrukturave në punën e katalogimit.

